

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 253, Nëntor 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Gëzuar Festat e Nëntorit

Shqiponjat e Ballkaniadës 1946

METEORËT E FUSHËS SË GJELBËRIT QË DO RREZATOJNË GJITHMONË!

Kombëtarja e Republikës së Shqipërisë, në vitin 1946, që përfaqësoj vendin tonë në kampionatin Ballkanik, në të cilin Shqipëria doli kampione e Ballkanit. Me datë 23 Nëntor 2024, në ora 15.00, në sallën e konferencave të Klubit të Futbollit "Vllaznia" u promovua vëllimi "Shqiponjat e Ballkaniadës 1946", "Babagjyshat e bëtare", me autor Prelë Milanin...

2

U promovua romani "Bukuria e Kristines"

Më datë 10 nëntor, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me Qendrën Rinore "Arka" organizuan veprimtarinë promovues të librit "Bukuria e Kristinës" nga autori z. Engjëll Gazhdaj. Kjo veprimtarie e mbajtur në qytetin tonë, mblo dhi artdashës dhe anëtarë të bashkësisë, përfshirë 18 të rinjtë e Klubit të Librit të Shoqatës "Projekti Shpresa", si dhe median lokale, të cilat pasqyruan veprimtarinë, duke theksuar rëndësinë e promovimit kulturës dhe letërsisë në zonën tonë...

4

Një javë në vizitë studimore në Yerevan të Armenisë

Besoj se për çdo njëri që do ta lexojë titullin e këtij shkrimi, me një fare të drejte pyetja e parë e tij do të jetë "Çfarë kërkoni ju në Yerevan?"

Mbas kërkimeve të mija prej vitesh në arkivat e Italisë dhe të Vatikanit më ka rezultuar që për arsye të besimit të krishterë kanë ekzistuar lidhje të forta midis popullsive të Shqipërisë veriore, Libanit dhe Armenisë. Këto lidhje

9

Festa e Gështenjave në Shllak! Një traditë që bashkon bashkësinë!

Më 27 Tetor 2024, zona malore e Shllakut mirëpriti rreth 500 pjesëmarrës në Festën e Gështenjave, një veprimtari, që tashmë po kthehet në traditë, që jo vetëm promovon pasurinë kulturore të zonës, por edhe forcon lidhjet mes banorëve dhe vizitorëve.

Festa u organizua nga disa organ të përkushtuar të zonës...

5

Shqiponjat e Ballkaniadës 1946

METEORËT E FUSHËS SË GJELBËRIT QË DO RREZATOJNË GJITHMONË!

Kombëtarja e Republikës së Shqipërisë, në vitin 1946, që përfaqësoj vendin tonë në kampionatin Ballkanik, në të cilin Shqipëria doli kampione e Ballkanit:

- 1-Dodë Tahiri (portieri)
- 2-Xhakomino Pozeli
- 3-Muhamet Dibra.
- 4-Sallave Llambi .
- 5-Rexhep Spahiu:
- 6-Xhavit Demneri
- 7-Bimo Fakja-
- 8-Besim Fagu
- 9-Aristill Parapani
- 10-Qamil Teliti
- 11-Loro Boriçi (Kapiteni)
- 12-Bahri Kavaja
- 13-Vasfi Biçaku
- 14-Pal Mirashi
- 15-Prekë Gjeloši.,
- 16-Hamdi Bakalli.
- 17-Xhelal Juka ..
- 18-Skender Begeja
- 19-Besim Boriçi
- 20-Loduvuk Jakova.
- 21-Adem Karapici
- 22-Ljubica Broçiç (Trajneri)

Me datë 23 Nëntor 2024, në ora 15.00, në sallën e konferencave të Klubit të Futbollit “Vllaznia” u promovua vëllimi “Shqiponjat e Ballkaniadës 1946”, “Babagjyshat e Kombëtares”, me autor Prelë Milanin dhe u shfaq dokumentari me të njëjtin titull “Shqiponjat e Ballkaniadës 1946”.

Veprimtaria u realizua në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër (Drejtorinë e Sporteve, z. Auror Miloti), Presidentin e Klubit të Futbollit “Vllaznia”, z. Alban Xhaferri dhe Shoqatën e shkrimtarëve Shkodër “Pena Artë”, kryetarin e saj, Profesor Zija Vukaj.

Siparin e veprimtarisë e hapi mikpritja e të zotit të shtëpisë z. Alban Xhaferri, i cili me shumë përkushtim kishte ofruar bashkëpunimin e tij dhe Klubit që, kjo veprimtari të realizohej shumë mirë. Himni Kombëtarë çeli veprimtarinë, ky pas një prezantimi dinjitoz nga gazetari sportive Gasper Marku dhe Aktorja e Teatrit “Migjeni” Rojmonda Marku, në skenë u thirrën emrat e pjesëtarëve të ekipit Kombëtar të Shqipërisë fituese e Ballkaniadës në vitin 1946, që këto emra na u prezantuan nga ekipi U - 15 vjeçarëve i drejtuar nga ish futbollisti i Kombëtares dhe “Vllaznisë”, z. Amarildo Belisha.

Prania e këtyre të rinjve, që janë e ardhmja e futbollit Shkodran dhe Shqiptarë ngjalli në sall emocione të mëdha.

Pastaj u shfaq filmi dokumentar kush-tua këtij sukcesi të Ballkaniadës 1946 fituar nga ekipi Shqiptarë ku ne gjirin e saj rreshtonte 4 lojtarë titullar me origjinë nga Dukagjini.

- Kapiteni Loro Boriçi,
- Portieri Dodë Tahiri,
- Pal Mirashi
- Prek Gjeloši.

Të shumtë ishin referuesit, që sollën



Foto e kombëtares Shqiptare në vitin 1946, që doli kampione e Ballkanit dhe dy librat e autorit Prelë Milani

mendimi e tyre në lidhje me librin dhe autorin e saj, Prelë Milanin, i cili i falënderoj të pranishmi dhe organizatorët e veprimtarisë dhe solli aspekte nga puna e tij për të sjell në mesin tyre këtë vepër, e cila është mjaftë e veçantë në historikun e futbollit Shqiptarë.

Z. Alban Xhaferri u dorëzoi (fanellën aktuale të “Vllaznisë”, me numër 10 për Prelë Milanin dhe fanellën me numrin 22 për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, e cila në kuadrin e kësaj veprimtarie shpërndau këto tituj nderi, me vendim nr. 292, date 10 nëntor 2024” “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”:

1- **Klubi i Futbollit “Vllaznia”,** me motivacion: Nëna mbretëreshë, Mirusha hirplote e futbollit shqiptar. Amalthea e dashurisë magjike të lojës “top e këmbë”. Lokemadhja që lindi, ushqe, rriti, burrëroi dhe ngjiti në malin e “Shenjtë” dhjetëra gjenerata legjionarësh historik. “Vllaznia” Dodona jonë shpirtërore, pikë

referimi e vazhdimësisë futbollit shqiptarë. Madhështi e vatrës së vjetër, bukuri vegimtare ku ndizet flaka e re sportive nëpër të cilën përtërihen me gjak kampionesh virtytet e vjetra stërgjyshore. “Vllazni”, mbretëresha e zjarrtë e dashurisë. “Vllazni” Kuq e blu, sot e nesër dhe përjetësisht zëmra jonë!

2- **Loro Borici,** me motivacion: Një pengas sugjestionues i mbuluar kokë e këmbë me dafina epitetesh të shkëlqyera, i larë nga një shi i artë metaforash të shndritshme, i veshur me hiperbolat e një sovрани gjithë prestigj në fronin e tij vetmitarë.

3- **Anton Mazrreku,** me motivacion: Një rilindës i shquar i sportit, i pa harruar, i pa imitueshëm. Themelues i gazetarisë sportive radiofonike i cili më penën mikrofonin e tij ndezi në terrenin sportiv shqiptarë pishtarin e flakës olimpike

4- **BESNIK DIZDARI,** me motivacion: Emblema, enciklopediku, dashuria, vëzhgimi, gjurmimi, fiksimi sentenca,

këndimi, promovimi, kujtesa lapidare e gazetarisë sonë sportive. Besnik Dizdari, babai dhe pika mbi i e Historisë së futbollit shqiptarë

5- **Hilë Staka,** me motivacion: Atlet, notarë dhe futbollist i shquar. Që me 1925 anëtarë ekipit simpatik “Maletona”, pastaj “Student Shkodra”. Themelues dhe titullarë gjurmë-lënës i “Bashkimi Shkodranë” në vitet 1930-1935 dy herë nën kampion kombëtarë. Student i shembullor i Fakultetit mjekësor në Universitetin e Bolonjës vdiq pa prituri në vitin 1936. U shua si trëndafil që e rrafshon shtrëngata, por emri i mbeti në historinë e etërve të futbollit shkodranë.

6- **Artisi i Popullit Pjetër Gjoka,** me motivacion: Në rini u dallua si futbollist, atlet natarë dhe alpinist. Ishte një nga gurët themeltarë të Bashkimit Shkodranë me 1930, mbrojtës i djathtë me numër katër. Luftëtarë «Liburnës» historike, deri sa në vitin 1933 një ndërhyrje brutale



Presidenti i Klubit të Futbollit “Vllaznia”, Alban Xhaferri, i dhuron Prelës, autorit të librit, fanellën me numrin 10 të kombëtares së vitit 1946, si sulmues, që të vazhdojë pa ndërprerje veprimtarinë krijuese, si dhe Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” fanellën me numrin 22, që është gjithnjë në prapavijë e ushqen në vijmësi veprimtari sa më dinjitoze.

e qëllimshme e një malazezi ne Podgoricë e nxori përgjithmonë nga fushat e blerta . Shkodra e futbollit humbi një luftëtarë të orëve të para, por fitoj një aktor të niveleve më të larta të arit shqiptar.

7- **Profesor Luigj Shala**, me motivacion: Njeriu universal, i ushtrimit, drejtimit, studimit dhe gjykimit të sportit Shqiptarë. I dalluar mes më të dalluarve të Bashkimit Shkodranë. Organizator dhe themelues i Kombëtares se Shqipërisë me 12 mars 1936. Kampion kombëtarë atletike, pjesëmarrës në tri olimpiada ndërkombëtare ballkanike në Athinë Zagreb dhe Stamboll. Shqiptari i parë që merre një medalje ndërkombëtare të bronxët në Stamboll. Bilbili i ynë i parë ndërkombëtar që daton në korrik të vitit 1937. At' i alpinizmit shqiptare dhe studiuës i mirënjohur i etnografisë.

8- **Dodë Tahiri**, me motivacion: Babagjyshi i portierëve kombëtare, nxënës i shkollës jugosllave të futbollit. SI asnjë shkodranë tjetër i portës dy here radhazi Kampion kombëtarë fitues i Kupës e ushtrisë kombëtare, Kampion kombëtarë në hedhje gjyle, Kampion Ballkanit. Portier kombëtarë jo vetë Shqipërisë por dhe Malit të Zi. Tahiri i përket emrave të privilegjuar, të pajisur me një rini të përherëshme, ndaj historiani e studion, patrioti e lëvdon, trimi e nderon, specialisti i futbollit e çmon, rapsodi e këndon dhe tifozi nuk e harron

9- **Prekë Gjeloši**, me motivacion: Një individualitet i spikatur një talent i veçantë në kolorin e asaj kolonie ku Shkodra pati diell kampionesh më shumë se kush do tjetër në Shqipëri. Vëlla i Bashkimit Shkodranë "Vllaznisë" dhe "Punës" gjithmonë besnik i Shkodrës. Babushi mbeti gjithmonë kuq e blu Luftoi me shpatën ngjeshë më "Spartakun" e Moskës, "Hajdukun", "Splidit", "Budiçnostin", "Cervena", "Zvezden", me Përfaqësues e Malit të Zi e të tjera.

10- **PAL MIRASHI**, me motivacion: Çdo kush që tenton të shfletojë historinë e futbollit shqiptarë është i "dënuar" të përballet me portretin e mjeshtrit të racës kampione Palë Mirashi. Zbulimi i madh i 1946, Kampion dhe nën kampion i Ballkanit, Kampion te Vllaznia e Dinamo, i dashur dhe gjurmëlënës te Tirana e pa fat.

11- **Simon Deda**, me motivacion: Pinjoll i familjes së mirënjohur tregtare të Shan Dedë Jakupit më rrejë nga fisi i Dushmanit. I Madh në mesin e me të mëdhenjve. Sulmues grabitqarë i demave të kuq, fitues i 5 titujve kampion kombëtare, heroi i Lajpcigut , flutura e fushave të blerta të futbollit, emblemë e Partizanit emblemantik, legjionar i Kombëtares, senatorë i futbollit tonë .

12- **Lin Shllaku**, me motivacion: Produkt i kombinatit Shkodra futboll. Kapiten i madh i kombëtares dhe Partizanit, mëlçia frymë dhënëse ekipit. Mesfushorë me intuitë që parashikonte çdo lëvizje me top e pa top. I pa gabueshëm taktikisht, mjeshtër i pasimit goditës me dy "patllake". Kapedan me shtatë nishane shtatat kampionate kombëtare. Fitues i Kupës Ballkanike mes Klubeve. Kapiteni Lin Shllaku dhe armata jonë kuq e zi, i preu rrugën Irlandës së Veriut për në Botërorin e 1966 dhe RFGJ për Evropianin e 1968 -ës.



Improvizimi i Kombëtares Shqiptare të vitit 1946, me futbollistë të moshës 12-14 vjeçare.

13- **Nikollë Gjergji** i "Luftëtarit" dhe "Vllaznisë", me motivacion: Kampion atletik në garën 110 metrave për të rijë, Kampion për rinj ne Volejbol, fitues i Kupës se Shqipërisë me 1965. S'printe i shkëlqyeshëm që tmerronte mbrojtësit, bombardues i saktë dhe nuhatës i zoti i portës Anëtarë i ekipit kombëtar Shpresa. Talenti i tij u shua në Konstancë, një thyerje këmbë e largoi aksidentalisht nga futbollit, ndonëse pranë futbollit qëndroi gjithë jetën, pranë ekipeve të moshave dhe të rinjve të "Vllaznisë".

14- **Çesk Ndoja**, me motivacion: Simpatikun i heshturi dhe punëtori i pa lodhur i "Vllaznisë" mbretërore të viteve shtatëdhjetë. Një nga mesfushorët djathtë më të shquar të kohës, por edhe sulmues ekstrem. Luajti për "Luftëtarin" dhe "Vllazninë". Pas 26 vitesh "Vllaznia" e Çesk Ndojes ngjitet në majat e futbollit shqiptarë, me 1972 rrokur me kuqe e kampionat dhe 1974 kampione. Lojtarë i ekipit kombëtarë shpresa që politika e zbriti nga autobusi

15- **Agustin Kola**, me motivacion: **Çun Tirane, me gjak shkodrani dhe karakter të fortë dukagjinasi, me motivacion:**



Nxënës të shkollës 9-vjeçare "Dedë Gjon Luli"

Direktorati Kola - Minga dhe senatore të tiranas, rrëzuan dhe shemben për dhe Kalifatin e kalifëve të kuq të "Partizanit" dhe sulltanatin "Dinamovit". Agustin Kola gjatë një karriere 20 vjeçare, 21 here u vesh kuq e zi, provoj të fitojë të gjitha trofetë e mundshme të futbollit tonë. Dinamiti i "Shkëndisë", "17 Nëntorit" dhe ekipit grek "Eglatos". Kishte karakterin e luanit në fushë, lojtarë që nuk dorëzohej kurrë.

16- **Nikolin Thana** "Mjeshtër sporti", me motivacion: Një nga mesfushorët më

potenti i viteve tetëdhjetë- traktor, taktik, punëtorë, i pa lodhur dhe altruist. Doli nga fidanishtja e Shkollës së Mjeshtërisë Sportive. Ka luajtur për ngjyrat e "Shkëndisë", "Vllaznisë" dhe "Apolonisë", duke dhënë shpirtin në fushë. Ka kaluar hallkat ekipeve kombëtare, të rinjve dhe shpresave. Veç talentit dhe djersës se ballit nuk pati as një stimul, por vetëm pengesa e s' trekëmbështa Nga futbollit e ndau aksioni për rrëzimin e bustit të Stalinit duke përfunduar ne burg si armik i popullit. Ndonëse krejt impozant mbetet pararendësi më autentik i lëvizjeve të nëntëdhjetës.

17- **Armir Grima**, me motivacion: Portieri më jetëgjatë i kuadratit shkodranë i veshur me uniformën e gardianit të ekipit të parë që në moshën 15 vjeçare. Ka luajtur për ngjyrat "Vllaznisë", "Dinamo", "Partizanit", "E' thinkos" të Pireut e "Flamurtarit" të **Prishtinës. Ka veshur fanellën e ekipit "Shpresa".** Ka fituar të gjitha trofetë e mundshme kombëtare të futbollit shqiptarë, vazhdon të jetë aktiv pranë futbollit në detyrën e menaxher dhe trajner kombëtar i futbollit të femrave

18- **Marash Kumbulla**, me motivacion: Biri i një emigranti nga Dukagjini, lindur në Itali në vitin 2000 i shkëlqyer tek Verona i cilësuar si mbrojtës qendre me të ardhme të madhe. Roman i huazuar te Spanjoli, ka luajtur në të gjitha nivel ekipëve tona kombëtarë. Aktualisht titullar i defensivës tonë me 26 prezencë. I ledhatuar prej muzave e sukseseve rinore, i urojmë suksese drejt majave

19- **Mill Shkamë**, me motivacion: intelektual dhe njeri shembullor i sportit, bilbil me

integritet të lartë në drejtësinë sportive shqiptarë, që për gjatë viteve 1973-2003 ka gjykuar mbi 500 ndeshje futbollit. Nga viti 1996- (pyete) ka ushtruar me kompetence profesionale detyrën vëzhguesi FSHF të futbollit. Ka kryer për disa vite (pyete) detyrën e rëndësishme Kolegjiut të arbitrave të Shkodrës. Si kryetare i shoqatës sportive Profesor Luigj Shala është ideues dhe themelues i çmimit kombëtarë "Luigj Shala", duke zhvilluar dy edicione kombëtare në vlerësimin e bilbilave historik të futbollit tonë. Futbollit dhe arbitrimi janë

binomi i jetës së inxhinierit ndërtues dhe aktivistit shoqëror Mhill Shkëmbi.

20- **Gabriel Kulla**, me motivacion: Në qiellin e futbollit latin po shfaqet një talent i ri shqiptar, duke hyrë në historinë e futbollit italian si lojtari me i ri 15 vjeç, që shënon në një ndeshje të rriturish. Gabriel Kulla po ecën i sigurt e po rritet nga dita ditës si sulmues më dhëna shkëlqyera me të ritë e Sansueloes. Shoshiano- Shkodrani 16 vjeçar i formacionit kuq e zi të U 17, dhe në nëntë ndeshje ka realizuar nën gola, secili e më i bukur e më rëndësishëm se tjetri PËR Shqipërinë e tij. Dita e mirë duket që në mëngjes! Gabrel kulla është ende në hapat e pare të karrierës, ndaj kjo mirënjohje le të jetë një bekim. U rritesh e u bëfsh shqiponje e fushave të blera.

21- **Esmeralda Franja**, me motivacion: E shpejtë si era dhe luftëtare si Athenea. Mbrojtëse e hekurt, me karrierë të ndritshme, e cila me shiritin e kapitenes ka udhëhequr autobllindën kuqe e blu në fitimin e nëntë titujve kampion. legjionare e shquar në ditët plot diell, por edhe me acar e stuhi e ekipit tonë përfaqësues, në sfidat më të rëndësishme ndërkombëtare gjatë dhjetë viteve në Ligën e Kampioneve të Evropës, në eliminatoret të Evropianit dhe Botërorit. Qëndron e vendosur dhe e sigurt si amazonë në majat e futbollit femërorë shqiptarë.

22- **Klubi i Futbollit "F C DUKAGJINI", në Miçigan**, me motivacion: Në fillim të viti 1981 ish portieri i parë i Kombëtares Shqiptare edhe të Malit të Zi, Dodë Tahiri, në Detroit do të krijonte ekipin Futbollit "Vllaznia" me djem emigrantesh shqiptarë. 40 vjet me vonë, një tjerë djalë Dukagjini, Gentjan Zef Nonaj krijoi ekipin e futbollit "FC DUKAGJINI", në Miçigan. Skuadra simpatike rinore shqiptar, stërvitet, luan rregullisht dhe ka rezultate befasuese në futbollin amator në shtetin e Miçiganit. "FC DUKAGJINI" përbehet nga 24 lojtarë shqiptarë kryesisht nga Dukagjini i Shkodrës. Rrafshi i Dukagjinit dhe Malësia e Madhe. I urojmë "FC DUKAGJINIT", presidentit dhe futbollistit të talentuar Gentjan Zef Nonaj udhë të mbarë në gjurmët e etërve të futbollit shkodranë drejt majave më larta të futbollit!

E hijeshuan veprimtarinë, me interpretimin e valleve, nxënësit e shkollës 9 – vjeçare "Dede Gjon Luli", në Hot i Ri, drejtuar nga mësueset Drita Leka dhe Shukë Ahi.

Koktej vëllazërorë i shtruar nga z. Alban Xhaferri I, ia la rrallën ndeshjes "Vllaznia" – "Teuta", e cila e rriti gëzimin e kësaj veprimtarie, me fitoren e merituar të "Vllaznisë" - 2-1.

E mundësuan financiarisht veprimtarinë Kolë Çardaku, Vitor ArriNaj, Mhill Shkambi, Prek Kulla e Gjon Shtegu.

Në përfundim të kësaj kronike falënderimet janë për të gjithë organizatorët e veprimtarisë, por falënderimi i parë për shkrimtarin Prelë Milanin, i cili vijon të na pasuroj me librat e tij!

Shpresojmë që në veprimtari të tilla të jemi përsëri së bashku!

Falënderojmë edhe mediat, të cilat e pasqyruan këtë veprimtari!

Përgatiti Roza Pjetri

U promovua romani “Bukuria e Kristines”

Më datë 10 nëntor, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Arka” organizuan veprimtarinë promovues të librit “Bukuria e Kristinës” nga autori z. Engjëll Gazhdaj. Kjo veprimtarive e mbajtur në qytetin tonë, mblo dhi artdashës dhe anëtarë të bashkësisë, përfshirë 18 të rinjtë e Klubit të Librit të Shoqatës “Projekti Shpresa”, si dhe median lokale, të cilat pasqyruan veprimtarinë, duke theksuar rëndësinë e promovimit të kulturës dhe letërsisë në zonën tonë.

Diskutimet u moderuar nga anëtarja e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, znj. Suela Ndoja e cila theksoi se kjo veprimtari ka të bëjë jo për të promovuar vetëm një libër, por për të vlerësuar një vepër që ngre një pasqyrë të thellë mbi vlerat, sfidat dhe ndjenjat e forta që përshkruajnë jetën shqiptare në periudha të ndryshme të historisë sonë që nga komunizmi deri në demokraci. Letërsia është një urë që na lidh me të kaluarën dhe na ndihmon të kuptojmë më mirë veten dhe rrugëtimin tonë si shoqëri. “Bukuria e Kristinës” është një vepër që, përveç bukurisë së saj artistike, mbart edhe një mesazh të thellë mbi qëndrueshmërinë, dashurinë dhe identitetin tonë kombëtar. Prandaj, veprimtaria kishte në thelb jo vetëm për të promovuar një libër, por për të promovuar një pjesë të shpirtit tonë shqiptar.

Veprimtaria u hap nga Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj, i cili përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi rolin e artit dhe letërsisë për t'i dhënë një zë përvojave njerëzore të thella dhe për të pasuruar komunitetin me vepra që frymëzojnë dhe ngjallin reflektim. Në fjalën e tij, Kryetari vlerësoi punën krijuese të autorit, z. Engjëll Gazhdaj, për aftësinë e tij të jashtëzakonshme për të pasqyruar ndjenjat dhe realitetet shoqërore në një mënyrë të ndjeshme dhe të fuqishme. Ai theksoi rëndësinë e veprës për letërsinë shqipe dhe ndikimin e saj tek lexuesit e rinj dhe të vjetër.

Me këtë në mendje, të pranishmit u ftuan të ndjekin programin e pasur, i cili përfshiu analizat e thelluara nga të ftuarit e nderuar referues, interpretime artistike dhe fjalë nga vetë autori.

Pas fjalës së Kryetarit, poeti i nderuar z. Lulash Brigja mbajti një referim poetik, duke e trajtuar simbolikën e bukurisë shpirtërore të Kristinës në roman si një motiv frymëzues dhe forcë mbijetese. Poeti paraqiti analizën e tij, duke përqendruar vëmendjen tek përdorimi i gjuhës poetike dhe simbolizmit në roman, si dhe mënyrën se si autori ndërthur emocione dhe tematika përmes detajeve të ngjarjeve dhe personazheve. Ai theksoi ndikimin emocional që krijohet përmes përshkrimeve dhe se si kjo ndihmon për të shprehur më shumë se thjesht një histori, por një mesazh të thellë mbi jetën dhe përballjet e personazheve me sfidat e jetës.

Pas tij, të rinjtë Alma Matija dhe Franko Korcari, anëtarë të Klubit të Librit të “Projektit Shpresa” interpretuan me emocion pjesë të zgjedhura nga romani, duke sjellë atmosferën e veprës pranë publikut. Recituesit lexuan me intonacion dhe emocion një pjesë të romanit të rëndësishëm për zhvilli-

min e personazheve dhe për ngjarjet kyçe të romanit. Ky moment ishte një mundësi për të përfshirë një pasazh që theksoi bukurinë, dhimbjen e personazhit kryesor, dhe ndikimin që ka historia me lexuesit.

Në vijim, psikologja zj. Suela Ndoja analizoi ndikimin psikologjik që përjetojnë personazhet në një sistem të ashpër e të padrejtë, duke e lidhur temën me sfidat që individit has në jetën e përditshme. Prezantoi një analizë psikologjike të personazheve dhe zhvillimeve emocionale të romanit. Kjo përfshiu aspekte të karakterit të Kristinës, Angjelos dhe ndërlikimet psikologjike të përballjes së tyre me sistemin dhe rrethanat shoqërore. Theksoi ndjeshmërinë dhe ndikimin emocional



të Kristinës gjatë periudhës së jetës së saj, përballjen e saj me humbjet dhe traumën, si dhe zhvillimin e saj emocional dhe psikologjik ndërsa përpigjet të ruajtë dinjitetin dhe integritetin personal përballë vështirësive. Po ashtu, në analizën e saj, përfshiu ndikimin që kanë pasur rrethanat shoqërore dhe ndihma e Kristinës tek Angjelo, për të përballuar realitetin e tij të hidhur, duke iu referuar çështjeve si ndjenja e fajit, humbja e vetëbesimit, dhe procesi i shërimit pas përballjes me vështirësi të mëdha.

Pas kësaj analize, poetja e mirënjohur zj. Arjola Zadrime interpretoi me mjeshtëri një poezi përmbyllëse nga libri, duke sjellë në jetë ndjenjat dhe frymëzimin e thellë që përshkruan romanin, e cila u duartrokit ngrohtësisht nga të pranishmit. Poetja, përçoi emocionet e personazheve dhe atmosferën e asaj kohe. Recitimi i saj ndihmoi që audienca të ndiejë afër ndjeshmërinë e personazheve dhe thellësinë e historisë duke sjellë në jetë fjalët e autorit dhe duke ndihmuar të përjetonim më nga afër ndjenjat dhe për-



jetimet e personazheve, më ëndrrat, sfidat dhe dashurinë e pamposhtur të personazheve.

Referimin e radhës e bëri z. Prele Milani, shkrimtar, publicist dhe historian, i cili solli një perspektivë të plotë mbi ngjarjet e romanit, duke theksuar përplasjen e vlerave tradicionale me ato moderne dhe ndikimin e këtyre përplasjeve në karakteret e veprës. Ai vlerësoi gjithashtu mënyrën sesi autori ka sjellë në roman thellësinë e jetës shqiptare. Historiani ofroi një analizë të thelluar të kontekstit historik dhe shoqëror të romanit, duke shpjeguar se si periudha e përshkruar ndikon te personazhet dhe veprimet e tyre. Ai mund të theksojë ndikimin e rrethanave sociale

dhe politike në jetën e personazheve, si dhe pasojat që ka pasur për jetën e individëve dhe shoqërisë në përgjithësi. z. Milani mundi të diskutojë edhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit dhe të vlerave kulturore në një periudhë të trazuar të historisë shqiptare.

Pas tij, Ardit Mancaku, anëtar i Klubit të Librit të “Projektit Shpresa” interpretoi këngën popullore “Si dukat i vogël je”, shoqëruar në kitarë nga Artan Hasanaj, një interpretim i ndjerë që shtoi një atmosferë të veçantë e të ngrohtë në sallë, duke lidhur shumë me themelet kulturore dhe historike të romanit. Këngët shkodrane janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kulturor, duke na sjellë më afër botës dhe realiteteve që përshkruhen në roman.

Në vijim, moderatorja, bëri një prezantim të shkurtër mbi jetën dhe veprimtarinë e autorit lindur më 10 shkurt 1954 në Berdicë, i shkolluar tek Gjinnazi “28 Nëntori” në Shkodër dhe angazhimi në blegtori. I martuar dhe baba i katër fëmijëve. Pasioni i tij për leximin e revistave

e gazetave të kohës si “Zani i Popullit”, “Shkenca dhe Jeta” si dhe shoqëria e ngushtë me At’ Pjetër Meshkallën.

Autori zhvilloi një bisedë të ngrohtë me të pranishmit lidhur me frymëzimin për të shkruar romanin, ndikimin e përvojave të tija personale dhe njohja e historisë shqiptare në zhvillimin e personazheve, çfarë përfaqëson Kristina për ju si personazh dhe pse keni zgjedhur pikërisht këtë titull për librin, mesazhi kryesor që dëshironi të përcillni te lexuesit përmes kësaj vepre.

Ky moment emocional thelloi lidhjen ndërmjet autorit dhe publikut. “Bukuria e Kristinës”, është një pasqyrë e realiteteve të vështira dhe ngjarjeve, që kanë formësuar historinë e shumë individëve. Ky libër është frymëzuar nga përvoja e jetës dhe nga refleksionet për vlerat e dashurisë, shpresës, dhe guximit për të luftuar për drejtësi dhe për të mbrojtur ato që janë të drejtat themelore të individëve. Ai theksoi ndër të tjera: “Përmes këtij romani, kam dashur të hedh dritë mbi temat që shpesh janë të fshehura ose të nënvlerësuar në shoqërinë tonë. Personazhi i Kristinës është një pasqyrë e forcës dhe vuajtjes njerëzore, një figurë që e ka kaluar shumë, por që kurrë nuk ka hequr dorë nga shpresa. Mesazhi i këtij libri është se, pavarësisht sfidave të mëdha që mund të ndeshim në jetën tonë, gjithmonë ka një mundësi për shpëtim dhe ringritje.”

Në mbyllje të veprimtarisë, Kryetari i Shoqatës, në emër të Kryesisë i dorëzoi autorit titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontributin tuaj të veçantë në fushën e librit dhe të krijimtarisë letrare. Për kurajën dhe vullnetin të pashoq për të vijuar pasionin tuaj të krijimtarisë artistike. Për korrektësinë dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, në promovimin e krijimtarisë tuaj”, me vendim nr. 291, datë 10 tetor 2024, duke nënvizuar rëndësinë e krijimeve të tilla për kulturën shqiptare dhe për mbështetjen e bashkisë.

Pas përfundimit të veprimtarisë, të pranishmit u ftuan në një kafe sociale, ku biseda e ngrohtë mbi librin dhe tematika të ndryshme kulturore vijoi në një atmosferë miqësore. Kjo kafe e veçantë sociale i dha fund këtij promovimi, me biseda të këndshme dhe përkujtime të bukura.

Përgatitur nga:
SUELA NDOJA, Anëtare e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”



Festa e Gështenjave në Shllak! Një traditë që bashkon bashkësinë!

Më 27 Tetor 2024, zona malore e Shllakut mirëpriti rreth 500 pjesëmarrës në Festën e Gështenjave, një veprimtari, që tashmë po kthehet në traditë, që jo vetëm promovon pasurinë kulturore të zonës, por edhe forcon lidhjet mes banorëve dhe vizitorëve.

Festa u organizua nga disa organizatorë të përkushtuar të zonës të kryesuar nga famullitari i famullisë së Shllakut, Dom Marjan Gjinesha.

Një mbështetje financiare ka dhënë Bashkia Vau i Dejës, me kryetarin e saj Kristjan Shkreli dhe Administratorin e zonës së Shllakut, Kristjan Ndoja, duke shënuar kështu një moment të veçantë për këtë bashkësi të dashur.

Programi Artistik dhe Tradicional ofroi një program të pasur artistik që përfshinte këngë të mrekullueshme tradicionale, valle që i dhanë jetë skenës dhe momente humorit që argëtuuan pjesëmarrësit e të gjitha moshave.

Atmosfera festive reflektoj pasurinë e trashëgimisë kulturore të Shllakut dhe dashurinë e banorëve për gështenjat, të cilat janë një simbol i begatisë në këtë zone.

Me këtë rast, me propozim të Famullitarit të Famullisë së Shllakut, Dom Marjan Gjinesha, Kryesia e Shoqatës Atdhetarë "Dukagjini", me vendim nr. 291, date 20. 10. 2024, nderoi me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", organizatorët, të përkushtuarit në organizimin, përgatitjen e zhvillimin e festes së "Gështenjës", në Shllak, fshatin Ukbibaj, Mark Gjeka, Miran Pali, Kristjan Ndoja dhe Nikolin Shqau, me motivacion: "Një nder organizatorët e Festës së "Gështenjës" në Shllak, për përkushtimin dhe punën tuaj në promovimin e zonës. Falë kontributit tuaj të çmuar, kjo festë është kthyer në një mundësi të shkëlqyer për të bërë të njohura traditat dhe bukuritë e krahinës së Shllakut, duke nxitur vlerat kulturore dhe natyrore të këtij vendi. Mirënjohjeje të thellë për rolin tuaj në forcimin e bashkësisë dhe promovimin e pasurive tona".

Ky vlerësim simbolik nënvizoj rëndësinë e bashkëpunimit për ruajtjen e traditave të zonës.

Gështenjat, të cilat janë një ndër produktet më të njohura të zonës, ishin në qendër të vëmendjes gjatë festës. Përveç gështenjave të freskëta vizitorët patën mundësinë të mësojnë më shumë rreth rëndësisë ekonomike dhe kulturore të këtij produkti për banorët e zonës.

Një veprimtari që mbledh dhe frymëzon...

Festa e Gështenjave është bërë tashmë një traditë e dashur në Shllak, duke tërhequr gjithnjë e më shumë pjesëmarrës nga zona përreth dhe më gjerë. Kjo veprimtari jo vetëm që promovon Shllakun si një destinacion turistik dhe kulturor, por gjithashtu forcon ndjenjën e përkatësisë dhe bashkësisë.

Festa e këtij viti dëshmoi edhe një herë



FESTA E KSHTËJS !

SHLLAK

TE DIELEN ME 27.10.2024

ORA 12:00

KISHA E SHËN PRENDES

JU MIRËPRESIM !



se, përmes bashkëpunimit dhe dashurisë për kulturën, mund të ruajmë dhe promovojmë traditat tona më të mira. Shpresojmë që kjo traditë të vazhdojë të lulëzojë edhe në vitet që vijnë, duke e kthyer Shllakun në një pikë të rëndësishme të kalen-

darit kulturor të Shqipërisë.

VIOLA SHQAU

Shkrimtari Stefan Çapaliku promovon librin e tij më të ri "Caméra obscura", në Shqip Vile, Bruksel, Belgjike

Fillimi i muajit nëntor ka sjelle për adhuruesit e librit një veprimtari të këndshëm, duke pasur të pranishëm shkrimtarin e njohur nga Shkodra, Stefan Çapaliku, në promovimin e librit poetik "Caméra Obscura" në Shqip Vile, Grand Place. Ishte ftesa e Shoqatës së Shkrimtareve dhe Artistëve Shqiptare në Belgjike, që bëri të mundur realizimin e promovimit me një prezantim ndryshe, larg rutinës dhe ku adhuruesit e poezisë do gjejnë mjaft risi letrare.

Një falënderim për Ledja Canaj, që po kontribuon pa u ndalur, në prezantimin e të bukures së artit dhe krijimtarisë mbarë shqiptare dhe mbështetjes së Arjan Ba-



jraktarit, drejtori i shkollës shqipe "Faik Konica", në Namur.

Shkrimtari Çapaliku beri një prezantim video montazh të 60 poezive të librit.

Në këtë veprimtari ishin te pranishëm kritiku letrar Gjovalin Kola, poete, shkrimtare e dashamires të artit.

Në fund të veprimtarisë dha përshëndetjen e tij Ambasadori i Shqipërisë z. Ferit Hoxha, që vlerësoi prezencën e shkrimtarit dhe krijimtarinë e tij, në njohjen e veprave në ndihme të bashkësisë Shqiptare, që jeton e punon në Belgjikë.

ZEF NIKA,
Bruksel, nëntor 2024.



MISIONARI NË SHËRBBIM TË KOMBIT

118 VJETORI I LINDJES LUIGJ (JAKË) MARLEKAJ

NË FIGURËN E TIJ JANË MISHËRUAR, PRIFTI, DIPLOMATI, AKADEMIKU, MËSUESI, BASHKËQYTETARI,

Datëlindja e tij ishte 19 nëntori, nëpërmjet gazetës “Dukagjini” po përpiqemi përveçse ta sjellim në kujtesë të themi diçka për Luigj Marlekaj, këtë personalitet të rëndësishëm të kulturës shqiptare. Ai meritonte të kujtohej në çdo përvjetor të lindjes, për kontributin e tij si meshtar e mësimdhënës, për veprat e botuara dhe ato në dorëshkrim si profesor i shkencave filologjike, studios, publicist e përkthyes.

Institucionet përkatës të botës akademike, historike apo gjuhësore, didaktike dhe religjioze, media shkruar apo ajo vizive, duhej të paktën ta lançonin emrin e këtij personaliteti. Nuk është vonë, ndoshta ky shkrim do bëjë diçka : tek lexuesit të bëhet i njohur ky emër, institucionet përkatëse të mund të veprojnë në të ardhmen. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” ka bërë më shumë se kushdo tjetër në njohjen dhe vlerësimin e këtij personaliteti me origjinë nga fshati Plani i krahinës së Pultit.

Profesor Liugj Marlekaj, është një ndër personalitetet e spikatura shqiptare, ku për më shumë se 60 vjet jashtë atdheut, kontribuoj fuqishëm për gjuhën, letërsinë, historinë e të shkruarit shqip, njohjen dhe përhapjen e kulturës jashtë vendit.

Studimi, publikimi, vlerësimi i kontributit të tij shkencor merr një rëndësi të veçantë, për faktin se deri tani Prof. Marlekaj është pak i njohur këtu në Shqipëri, në atdheun e tij. Ai është i njohur dhe i vlerësuar maksimalisht në rrethet intelektuale dhe universitare të Italisë, ku u shkollua e zhvilloj pothuajse të gjithë veprimtarinë e tij religjioze, pedagogjike e shkencore. Ai ishte shqiptari me të drejta të plota për të dhënë leksione, të ishte pedagog në të gjitha universitetet italiane. Janë, Universitetet Firences, Bolonjës dhe Barit, auditorët dhe katedrat ku profesori shqiptar Luigj Marlekaj zhvilloi shkencën e Albanologjisë.

Luigj Marlekaj, ka lindur në fshatin Plan të krahinës së Pultit, zonës së Dukagjinit, me 19 nëntor 1906. Ka ndërruar jetë në Bari, 27 korrik 2003. Është kleriku, studiuesi dhe gjuhëtari i njohur At Justin Rrota, famullitar i Planit në vitin 1917, që i njohu cilësitë dhe intelektin e Luigjit, që i kishte kaluar 10 vite. Ai në këtë vit, në muajin dhjetor, pranë kishës hapi një shkollë, jo vetëm për Luigjin, por dhe për të rinj të tjerë malësorë, që më vonë do të bëheshin të njohur brenda dhe jashtë vendit. At Justinin, (personalitet i shquar i kulturës shqiptare) Luigj Marlekaj e kujton si udhëheqës shpirtëror, si mësuesin e pare, si vëlla françeskan, si koleg.

Në moshë të re bie në sy përfshirja e Marlekajt në veprimtaritë e shumta që zhvillonte shoqëria shkodrane, në sferën e religjionit e të emancipimit shoqëror. Shkrimi i tij i parë është në vitin 1932 tek “Hylli i dritës”. Më vonë ai shkroi rregullisht në revistat “Zani Shna Ndout”, “Shejzat” dhe në disa revista të tjera evropiane. Ishte nxitja e përkujdesja e paderë Gjergj Fishtës, për të shkruar dhe marrë pjesë aktive në veprimtaritë shoqërore e

intelektuale të Shkodrës.

Në ç’ nder të studimeve të prof. Marlekajt janë figurat e Skënderbeut, Pjetër Bogdanit, Gjergj Fishtës, Nikollë Kazazit, Shtjefën Gasprit, familja e Mazrrekëve, e të tjerë. Vetë rruajtja e gjuhës s amtare, të shkruarit e saj, që në shekullin e XV-

e një qeverisje të mirë, ndërsa dashuria është mjeti më i lartë rregullues. Ajo arritet nëpërmjet sigurimit të lirisë qytetare, e cila nuk është gjë tjetër , por zbatim me përpikëri i ligjeve të drejta dhe të barabarta për të gjithë. Drejtësia, dashuria dhe liria përbëjnë një bashkësi të pandarë.



Prof.dr. At Jak Marlekaj (1906- 2003)

të, përbën një dokument të fuqishëm të forcës shpirtërore e kulturore të popullit shqiptar. Të mbijetuarit e gjuhës shqipe, është një provë e natyrës së panënshtruar të shqiptarëve si komb, konkludon Marlekaj. Ai, si shkencëtarë i angazhuar në punë të mëdha, në veprimtari të gjithanshme, kishte një bosht- t’i shërbente shoqërisë njerëzore, t’i shërbente kombit të tij. Profesor Marlekaj, ka një konceptim të plotë për nocionet bazë siç janë: kombi, qeverisja, liria, drejtësia dhe marrëdhëniet e njerëzve. “Drejtësia është bazë

Qeverisja e një vendi, qëllimi suprem i politikës, i një udhëheqësi shtetëror është: që t’ua bëjë të lehtë jetën qytetarëve dhe kombin e lumtur”.

Falë veprimtarive shkencor e didaktik të tij, ai zgjoi vëmendjen dhe interesant e studiuesve italianë për historinë dhe kulturën e popullit shqiptar. Studimet e tij synojnë të nxjerrin në pah hershmërinë e traditave popullore shqiptare, historinë e gjuhës shqipe, origjinalitetin saj indoevropian.


Në pamundësi për tu lidhë me tokën

mëmë, ai u lidh me arbëreshët e Italisë. Profesor Marlekaj për më se 30 vite veprimtari në Bari dhe rajonet jugore të banuara nga arbëreshët u bë një personalitet shkencor dhe shpirtëror i njohur dhe i respektuar prej tyre. Ai gjithnjë mendonte, ishte në ankth, çfarë ndodhte përtej detit Adriatik. Në Shqipëri, në trojet ku lindi Luigji, ku jetonin vëllezërit dhe të afërmit e tij, persekutimi komunist bëri të tijën. U burgosen dhe u pushkatuan mjaft priftërinë mësues dhe kolegë të Luigjit. Për më se 30 vjet, ndonëse një familje e respektuar dhe me emër, shtëpia e Tush Marikut të lagjes së Thanit quhej e “prekur”. Nuk i shkohej dhe thirrej normalisht në tubimet popullore të krahinës. Paradoksi i kohës- nga ajo derë ka dalë një prift, ai jeton jashtë, kushedi me çfarë merret në Itali, fjala ishte për Luigj Marlekaj, që çlirimi i vendit e zuri jashtë me studime. Të ndarë së gjalli, peshën e persekutimit dhe mallin për Luigjin e morën në varr, baba, nëna, vëllezërit dhe bashkëpunëtorët e tij. Ndoshta ai që ndjeu më shumë mungesën e Luigjit me ato që pasuan, ishte Gjeka, vëllai binjak me të. Gjekë Tushi qe një burrë i ditur i qetë dhe fjalë pak, kam pasur fatin ta njoh nga afër, ndërsa me djalin e tij, Mëhillin jemi afërsisht moshatarë dhe kemi qenë nxënës në shkollën 8 vjeçare Plan, në fillim të viteve 70. Edhe ai mjaft djalë i ditur, por disi i ndrojtur nga persekutimi i kohës dhe sado që mësonte e merrte nota të mira, ai dinte se nuk do të shkonte as në shkollë të mesme. Vetëm pas viteve 90, kur unë lexova një shkrim nga gazetari njohur Ndue Lazri dhe monografia e prof. Osmanit dhe tashmë po shkruaj për Luigj Marlekaj, shoh pse ajo shtëpi “quheshin të prekur”, ndërkohë që nga ajo shtëpi kishte lindë një njeri aq i madh!?

Duke ju referuar prof. Shefki Osmanit, i cili ka pasur mundësinë të takohet me prof. Marlekaj, të vizitojë bibliotekën e tij në mesin e viteve ‘90, ai vlerëson shumë dorëshkrimet e tij, dokumentet e arkivit dhe janë një pjesë e rëndësishme e veprës tij. Ato përbëjnë një pasuri në vete për historinë dhe kulturën shqiptare, janë thesar vlerash për studiuesit brenda dhe jashtë vendit. Ato të skeduar me të gjitha të dhënat e nevojshme, një pjesë e madhe të përgatitura për botim, janë një pasuri e çmuar që lartëson më shumë punën e profesor Luigj Marlekaj.

Prof. Marlekaj ka krijuar edhe një bibliotekë të pasur me 3000 libra, me tema të ndryshme, para së gjithash në fushën e albanologjisë e gjuhësisë. Biblioteka e tij për një periudhë kohe u vendos pranë Kuvendit Françeskan, ngjitur me Kishën “San Gregorio VII”, në Romë, nën kujdesin e P. Daniel Gjercajt, ish- nxënës i Marlekajt në liceun “Illyricum” të Shkodrës, vëlla e mik në emigrim. Në figurën e tij janë mishëruar të gjitha llojet e personaliteteve si: prifti, diplomati, akademiku, mësuesi, kolegu, bashkëqytetari e të tjera.

(vijon në faqen 8)



Respekt dhe dashuri të vijueshme për gjuhën shqipe, për brezin e sotëm dhe brezat që vijnë

“Erdhi më në fund edhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, kohë plot shpresë! Në të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë dhe, plot me dëshirë, trimoshët e dheut tonë po përpiqen për zbukurimin e shqipes”, Faik Konica



Fran GJOKA

Gjuha përbën elementin (komponentin) kryesor të kulturës në planin sociologjik. Në këtë kuptim eliminimi i gjuhës çon në eliminimin e një kombi. Aq më tepër kjo përbën rrezik për popujt e vegjël që historia për arsye ekonomike politike e sociale i ka shpërndarë anë e kënd botës. Nuk bën përjashtim në këtë mes as Shqipëria pushtimi i vazhdueshëm i së cilës nga fuqitë e mëdha ka pasur ndër të tjera, synimin e të mosfolurit dhe të mosshkruarit të gjuhës shqipe dhe as të hapjes e të funksionimit të shkollave është një histori tashmë e provuar ndër shekuj mbi shkronjat dhe analfabetin tonë.

Rilindësit dhe forcat përparimtare, duke mbrojtur gjuhën shqipe kanë mbrojtur dhe mbrojnë kombin tonë

Kjo është aq e vërtetë sa po të mos ishte këmbëngulja e përpjekjet maksimale, vërtetësia dhe mençuria, zgjuarsia intelektuale dhe patriotizmi i rilindësve tanë të mëdhenj e shoqëruar edhe me mbështetjen e popullit tonë trim e arsimdashës, gjuha e bukur dhe e pasur shqipe në mos do të ishte asimiluar së paku do të ishte sakatuar. Nuk mund të lihen jashtë vëmendjes as roli i klerit në tërësi e veçanërisht i atij Katolik në veçanti, para së gjithash në Shqipërinë e veriut, në ruajtjen nga ndikimet e huazimet e huaja, të cilat shkallë-shkallë do të copëtonin e shkatërronin gjuhën tonë deri në atë masë sa në Shqipëri mund të shkohej deri në të folurit e një sllavishteje të gjymtuar ose të një turqishteje të çalë. Ja pse ne kemi respekt të veçantë për De Radën, frashëllinjtë, At Shtjefën Gjeçovin e Negovanin për Fishtën e madh e dhjetëra rilindës fetarë në besim për kombëtar të mëdhenj, aq sa për shkronjat e të shkruarit dhe të folurit shqip sakrifikuan çdo gjë, edhe jetën e tyre, në këtë kuptim dhe me këtë vlerësim ne u jemi atyre mirënjohës për çdo gjë që ata bënë për të ruajtur gjuhën shqipe dhe për ta pasuruar atë.

Sot ne kemi një gjuhë letrare shqipe të njehsuar, të ndërtuar mbi bazën e vlerave

më të mira të dialekteve kryesore, për të cilën ka rezerva e njëanshmëri në trajtimin e saj, të miratuara këto nga studiues të bunkerizuar mendërisht e politikisht, që parapëlqejnë krahinizmat dhe që përfaqësojnë grupe sociale nga më të ndryshme. Që gjithsesi besojnë se teoritë e tyre për nevojën e besimit në të folur dhe në të shkruar nuk do të ngjasi asnjëherë pasi ajo ka marrë fund tashmë konfirmimin institucional të gjuhëtarëve më të aftë të Shqipërisë dhe të trevave ku banojnë shqiptarët. Duke mbajtur këtë parim, ne nuk jemi nacionalist në ruajtjen dhe në transmetimin e traditës, të normave e të vlerave kulturore, simboleve dhe kulturës materiale duke përfshirë gjuhën tek brezat pasardhës çka duhet përgëzuar e përsëndetur shqiptarët e Kosovës, Malit të zi, Maqedonisë disa vende të Evropës dhe të Amerikës. Ndryshe ndodh shqetësimi tek qindra fëmijë emigrantë shqiptarë tek flasin në shtëpitë e tyre greqisht, anglisht, italisht e ku ta dimë se ç’gjuhë tjetër, por vetëm shqip jo. Jo vetëm shteti dhe institucionet e tij kanë për këtë përgjegjësi, por edhe familjet e tyre që siç duket disa prej tyre, e kanë ndoshta druajnë të deklarojnë se janë shqiptarë.

Lidhur me procesin e gjatë dhe objektiv të rritjes së kulturës gjuhësore të një kombi, A.Xhuvani, që në vitet 50-të të shekullit të kaluar shkruante: “Solocizmat janë gabime të pafalshme, të cilave duhet tu reshtemi aq sa edhe gabimeve të tjera. Për këtë duhet një studim i thellë dhe i plotë i gramatikës së përdorimeve ... duhet të ndiqet edhe përdorimi i gjallë i popullit, edhe autoriteti i shkrimtarëve klasik. Ta kufizosh gjuhën në një cak të ngushtë shkrimi, kjo veç që e bënë gjuhën të lidhshme dhe pedentare, po është edhe një punë kundër natyrës së saj, pasi gjuha hynë në ligjet e evolucionit e nuk mund të shkarkohet pas dëshirës së një pale”.

Respekt dhe dashuri të vijueshme për gjuhën shqipe, për brezin e sotëm dhe brezat që vijnë

Evropa e ka ndërruar me kohë formulën e didaktikës së gjuhës, duke përcaktuar drejtime të reja në fushën e emancipimit gjuhësorë.

Kanë kaluar më shumë se një shekull dhe sot, në punët e gjuhës, problemet me delikate dhe më të mprehta zënë fill që te interesimi i fëmijëve e të rinjve në shkolla e fakultete. Duhet të tregohemi vërtet të kujdesshëm për të njohur mirë pasurinë gjuhësore në të cilën ata nisin shkollën. Vetëm kështu, mësues e nxënës, mund të përshkojnë së bashku udhën drejt gjuhës amtare dhe drejt gjuhëve të mëdha të kulturës evropiane.

Libri i prof. dok. Gj. Shkurtajt “Si të shkruajmë shqip”, edhe pse kanë kaluar 12 vite nga botimi i tij, është një pasuri tjetër në fondin e veprimtarisë kombëtare dhe një apel për mësuesin shqiptarë në

përgjithësi e administratën publike në veçanti. Pra, ka ardhur koha për ndjenjë e pasion, dashuri të lartë e, mbi të gjitha, respekt dhe vlera të mëdha për këtë thesar. E parë nga këta faktorë, të cilët duhet të njihen mirë, nga se kjo fushë e dijes është shenjë e parë dalluese e veçantisë kombëtare, brezat e sotëm dhe ato që do të vinë të dinë se kemi kapërcyer shumë shekuj përpjekje të këtij kombi, për t’i vënë këto në themelet e duhura e të shëndosha, të cilat qëndrojnë në ditët e sotme. Po për këto piketa ndërtimesh, është derdhur shumë gjak dhe është paguar shumë shtrenjtë gjuhësia shqiptare nga stërgjyshërit dhe gjyshërit tanë.

Këtu më shumë se njëqind vjet më parë, Xhuvani, hapur thoshte për daljen në dritë të një gjuhe letrare të njësuar,



pra të krijuara mbi baza të shëndosha letrare. Ai mbetet burrë i madh me zë e me nam në fushën e dijes gjuhësore. Por puna e këtij dhe shumë xhuvanëve të tjerë të gjuhësisë së sotme shqiptare, që i kanë dhënë dhe i japin kombit në fushën e dijes dhe të urtësisë për çdo lami dhe këshillat e tyre nuk janë të kapshme e të rrokshme tek disa intelektual, mësues dhe punonjës të mediave të shkruara, të cilët po i fusin brirët gjuhës së sotme të njësuar.

Prof. Xhuvanit nuk i vinte fare rëndë që t’i shtrijë dorën për punën e madhe që kishin bërë në gjuhë dhe për gjuhën dy vëllezërit, Naimi dhe Samiu. Edhe Noli, me urtësinë që e karakterizonte për vlerat njohëse të gjuhës e të kombit, pati thënë: “Lëvizja për të ngritur gjuhën shqipe në shkallë kombëtare nisi në Toskëri. (shih F.Agalliu, në “Gjuhën e Nolit”, Tiranë 1999). Këta dy dijetarë të mëdhenj, Xhuvani që i takonte të folurës veriore, ndërsa Noli i përkiste të folurës jugore, nuk vuanin nga bajraktarizmi as nga fise e klane shqiptare, të cilët i kapërcyen për t’u mbajtur kombi i patundur vetëm në saj të gjuhës së njësuar, për të cilën ballafaqohemi sot, aty këtu, edhe me telashe dhe shpeshherë edhe me synime ndarëse. Duke lexuar mediat e sotme, njeriut të ndershëm i bëhet sikur gjuha e sotme

letrare standarde, e përcaktuar 50-vjet më parë, ka mbetur vetëm në letër, nuk ka arritur përgjegjshmëri ligjore dhe penalizuse, siç duhej të ishte. Ky shqetësim duhet të shoqërohet gjithnjë me një propagandë dinamike, ku vetë gjuha amtare të vlerësohet me maksimumin e kërkuar, e studimet mbi shqipen letrare të zënë vendin e merituar.

Si ja bëri Naimi i madh, të cilit s’i gjen dot asnjë barbarizëm në veprën e vet? Po Noli që mori guximin dhe solli në shqip Servantesin, Shekspirin dhe Khajanin? Po Konica, Kuteli, Poradeci, Xoxe, Agolli, Kadareja e plot të tjerë? Këta mjeshtra të fjalës, e gjetën të pa t’harur arën e fjalës, ama fjala u ndrit në fjalë, prozë e poezi. Shëndoshja e mbrojtja e gjuhës standarde mund të bëhet me masa të prekshme

energjiike prej mendjesh që mendojnë tamam shqip e prej zemrave që rrahin shqip. Gjuhën shqipe e kemi ndër më të vjetrat e më të mëdhatë e kontinentit.

Mbrojtja e gjuhës shqipe të mbështet edhe në ligje shtetërore

Gjuha shqipe është, sot e mot, pasuri kombëtare bazë. Vetë proceset e hapjes, bashkëpunimit dhe të integritimeve rajonale ndërkombëtare, detyrimisht i japin mundësi edhe shqipes së folur dhe të shkruar të ecë natyrshëm në zhvillimin e pasurimin e saj me simotrat e shumë vendeve të BE.

Është fatalitet për ato vende me popullsi të vogël si Shqipëria, të shoqëruarit me rrezikun e depërtimit dhe përdorimit, vend e pa vend, të huazimeve në dëm të fondit autokton, duke kaluar shpesh në varfërimin e gjuhës letrare kombëtare. Këto marrëzi, që më mirë i njeh publiku, na shiten si gjetje gjuhësore moderne (!). ky është një agresivitet i hapur gjuhësor. Është koha të pranojmë dhe të përpiqemi për të vënë nën kontroll, duke ngritur barrierë, miratuar ligje dhe ngritur struktura të posaçme, për ta mbajtur të pastër shqipen, që është pasuria më e madhe dhe e patjetërsueshme me të cilën krenohemi. (vijon në faqen 8)

(vijon nga faqja 6)

Ai e pati ëndërr, dëshirë, por tani dhe amanet - që e gjithë kjo punë gati shekullore, të mos shkojë kot, ti shërbeje vendit dhe kombit tim. I thënë me gojë, por dhe i shkruar - ky amanet i profesorit Luigj Marlekaj, duhet të bëhet realitet.

Data të rëndësishme nga jeta e veprimtaria prof. Luigj Marlekajt (si meshtar njihet me emrin Atë Jakë - Jakob Marlekaj)

- 1906 (19 nëntor sipas monografisë, në një shkrim të radio Vatikanit, shkruhet më 29 nëntor të vitit 1906) lindi në Plan Dukagjin Shkodër.

- Në vitin shkollor 1924-1925 u regjistrua në liceun françeskan Illyricum.

- Pas mbarimit të këtyre studimeve në vitin 1928 shkon në Arezzo, ku përfundon studimet teologjike dhe bëhet prift, më 14 korrik 1931, me emrin Jakë.

- Në vitin 1932, kthehet në Shkodër ku i besohet detyra e mësimdhënësit në lëndët klasike të gjuhës shqipe, gjuhë e letërsi italiane.

- Në periudhë 1932-1937 bashkëpunon me revistat prestigjioze të kohës si “Hylli i Dritës” dhe “Zani i Shna Ndout”, periodik të cilin do ta drejtojë vetë deri në vitin 1937.

- Në vitin 1937, atë Gjergj Fishta, atëherë Ministër Provincial i fretërve e dërgoi përsëri në Bolonjë të Italisë, Atë Marlekajn për të plotësuar studimet e larta. Marlekaj regjistrohet në fakultetin e Letërsisë në Universitetin e Bolonjës, ku ndoqi kurset me drejtim filologjik-linguistik dhe në tetor 1941 mbron disertacionin “La grafia nell - uso degli scrittori albanesi 1462-1908”, duke pasur si relator prof. Gino Bottiglioni. Disertacioni i Marlekajt mori votat e plota dhe lavdërime nga vlerësuesit. Kjo punë shkencore e tij është një kontribut me vlera për historinë e alfabetit të shqipes, duke qenë ndër të parat trajtesa sistematike të këtij argumenti. Pas diplomimit, At’ Marlekajt iu besua detyra e lektorit të gjuhës shqipe, pranë Universitetit të Bolonjës e më vonë pranë Universitetit Katolik "Sacro Cuore" në Milano.

- Në vitin 1943, kur forcat aleate filluan

të bombardojnë rrugët e komunikimit Atë Marlekaj u transferua në Milano ku jepte mësim në universitetin Katolik “Sacro Cuore”. Në gusht të vitit 1943 bombardimet shkatërruan pjesën më të madhe të Universitetit, duke shënuar edhe largimin e të gjithë mësimdhënësve ndihmës, mes të cilëve edhe patër L. Marlekajn.

- Më 6 mars 1954 fiton titullin "docent i lirë" me vlerësimin “Doktor Marlekaj jep informacion të pasur dhe të saktë për letërsinë shqipe, përdor metoda shkencore në punët e tij, zotëron një përdorim elegant të gjuhës letrare, mund të emërohet “docent i lirë”. Në vitet e para të pasluftës, Marlekaj rifilloi studimin e shkrimtarëve të vjetër, mes të cilëve edhe transkriptimin e “Pasqyrës të Rrëfyemit” të Pjetër Bogdanit.

- Në vitin 1952 publikon në revistën “Annali Lateranesi” një nga punimet më të rëndësishme shkencore “Aspetti di ospitalita indoeuropea presso gli Albanesi”.

- Në vitin 1956, në Palermo, me rastin e Kuvendit të Katërt Ndërkombëtar të studimeve Shqiptare, paraqiti temën “Guiseppe sciro e le tradizioni popolari albanesi”, publikuar më pas në Bari në vitin 1996.

- Në vitin 1961, transferohet në Bari si profesor i rregullt pranë Fakultetit Pedagogjik, ku dha mësim për më se 30 vjet në lëndët Gjuhë e Letërsi Shqipe. Shumica e nxënësve ishin arbëreshë.

- Në vitin 1966 u paraqit me temën “Scanderbeg nella tradizione popolare”. Në bibliotekën qendrore të Firences zbuloi një dorëshkrim të 1500-ës, “Vite uomini illustri antichi e moderni”, që përfshinte edhe jetën e Skënderbeut. Vendosi të studioj dorëshkrimin dhe e publikoi në Romë më titull, “Vita di scanderbego di un storico cinquecentista italiana”.

- Në vitin 1978 Marlekaj doli në pension, gjë që i la kohë t'i kushtohej tërësisht veprës më të rëndësishme të tij , “Pietro Bogdani e l/Albania del suo tempo” , "Pjeter Bogdani dhe Shqipëria e kohës së tij”, punim që u publikua në vitin 1989. Jetës dhe veprës së Bogdanit, do t'i kushtojë rreth 25 vite studimi, që pasqyrohen

në veprën që kemi përmendur më lartë. Kjo vepër është vlerësuar si monografia më e mirë botuar deri më sot për Bogdanin. Studimi i Marlekajt rikthen figurën reale të Bogdanit, duke hedhur dritë mbi personalitetin e shkrimtarit më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqiptare. Kohët e fundit, Marlekaj ishte duke përpunuar rishikimin e veprës së tij, të cilës do t'i bashkëngjitej edhe një kapitull i fundit që do të trajtonte historinë e errët të Bogdanit, të grindjeve të nipave të prelatit me jezuitët e Bohemisë

- Në vitin 1998, Këshilli shkencor i Institutit të Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Barit ka pranuar që një pjesë e veprës së Marlekajt të publikohet. Në motivacionin që e shoqëron botimin thuhet: "Publikimi i volumit të shkrimeve në nder të Marlekajt, synon vetëm të nderojë njërën nga figurat më të shquara të albanologjisë ndërkombëtare. Prof. Marlekaj ka dhanë një shërbim të vyer për një kohë të gjatë pranë Fakultetit të gjuhësisë në universitetin brez gjatë dhjetëra viteve të dhimbjes dhe vetizolimit kaotik dhe kulturor, në të cilin ishte zhytur Atdheu i tij i origjinës.

- Më 14 janar 1997, Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha i akordoi Jak Marlekajt Urdhrin e Artë “Naim Frashëri” me motivacionin, “Për kontributin e shquar në fushën shkencore albanologjike si dhe për zhvillimin e letërsisë shqipe”.

-Me 19 nëntor 2006, në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes të Prof. Luigj Marlekaj, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Kishën Françeskane në Shkodër - Ministrin Provincial, At’ Ndue Gashi, me Prof. Dr. Larurat i Çmimit të Republikës, Shefki Osmani, një nder studiuesit e pare të veprës së Luigj Marlekes, nipin e tij Karlo Marlekaj, prof. dr. Tomorr Osmani, dhe Profesor Hasan Leka u përgatitë sesioni shkencor, me teme: “Një misionar në shërbim të Kombit”, në kuadër të 100 vjetorit të lindjes së tij. Ky sesion u përgatite dhe u zhvillua në kuadrin e temës së përgjithshme “Dukagjini në rrjedhat e historisë”.

Për përgatitjen e këtij sesioni morën

pjesë shumë personalitete të kulturës shkodrane: Prof. Dr. Shefki Osmani (ish nxënës i prof. Kole Preles), Prof. Tef Topali, Dr. Mimoza Priku, mësuesi Guljem Pistulli (ish nxënës i Luigj Marlekes), Diplomati e përkthyesi Willi Kamsi, Drejtori i bibliotekës “Marin Barleti”, Gjovalin Çuni, Studiuesi e historiani Agron Luka, poeti Luigj Temali, mësuesi Eduard Çiurçia, piktori e studiuesi Luigj Mila dhe të tjerë.

Në këtë sesion u mbajtën 11 tema, nëpërmjet të cilave u benë përpjekje të sillet para pjesëmarrësve, publikut shqiptar dhe veçanërisht lexuesve dukagjinas e shkodrane, jeta e vepra e këtij misionari, i cili ia kushtoi jetën e tij shqiptarisë. Ai, shpesh thoshte: “Gjithmonë gjatë jetës sime, jashtë atdheut jam përpjekur që në marrëdhënie me njerëzit, të jem i sakte dhe bujar, në mënyrë, që në personin tim, të huajt të shikonin shqiptarin si njeri, me karakter dhe pa hile”

Të gjitha këto tema janë botuar në një libër të veçantë, me titull “Dukagjini në rrjedhat e historisë - Një Misionar në shërbim të Kombit”.

Me këtë rast, Kryesia e SHAD, me vendim nr. Nr. 10, date 17. 11. 2009, i dha titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, pas vdekjes, me motivacion: “Me jetën, studimet dhe veprat e tij, nen Urdhrin e Shën Frances kut, me dashurinë dhe mallin për Shqipërinë, për 60 vjet behet një nder njohësit më të shquar të botes shqiptare në fushën e arkeologjisë, historisë, gjuhës, letërsisë dhe etnografisë”.

Atë Marlekaj përveç që u dallua si studiues, ai mbeti para së gjithash një frat i vogël shembullor, i përpiktë gjithnjë i gatshëm kundrejt çdokujt, që kishte nevojë për një këshillë shpirtërore. Ishte jo vetëm mësues, por edhe një dëshmitar apostolik.

- Luigj Marlekaj mbylli sytë, më 27 korrik të vitit 2003, në kuvendin e etërve françeskan, në Bari të Italisë.

Përgatiti Gjon Fierza, nëntor 2024

(vijon nga faqja 7)

Vërtetë jetojmë në një shoqëri të lirë e të hapur, vërtetë jemi përkrahës të globalizmit, por nuk do të dëshironim kurrë që gjuha jonë të mos shkruhej e të përdorej nga shqiptarët e të gjithë brezave. Mundësitë për ta mbajtur të gjallë gjuhën e bukur shqipe tek fëmijët, nipërit e mbesat dhe stërnipërit tanë, pavarësisht kur lindin dhe ekzistojnë, i mundëson shkolla që është institucioni bazë i mësimdhënies së gjuhës letrare dhe detyrë parësore ka të mësuarit e saj, e që sjell si rezultat aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve për ta komunikuar e shkruar saktë.

Më shumë vëmendje dhe masa konkrete, për mërgimtarët dhe fëmijët e tyre

Për shqiptarët emigrues, me gjithë përpjekjet e ruajtjes së saj, shqipja po bëhet sa e largët dhe e huaj për fëmijët mërgimtar. Është normale që, duke jetuar në një shoqëri ku flitet e shkruhet një gjuhë tjetër, kuptohet dhe tendenca e kufizimit dhe e shqiptimit të shqipes. Fëmijët po projektojnë të ardhmen e tyre aty ku rriten. Pra

emigrimi në përgjithësi dhe ai i fëmijëve në veçanti, krahas të mirave, mbart me vete edhe rrezikun e një asimilimi gradual të gjuhës, sidomos tek fëmijët shqiptar që jetojnë e mësojnë aktualisht në emigrim.

Faktet ekzistuese të një kombi përcaktohen, në fund të fundit, nga gjuha. Popullsia e një vendi që për arsye të ndryshme nuk e shkruan dhe rrallë herë nuk e flet gjuhën e vet amtare, është e prirur të rrezikohet, pasi gjuha ka qenë e mbetet një ndër komponentët kryesorë të kulturës së një kombi. Kur njeriu nuk e ka nën këmbë tokën e vet, humbet diçka nga qëndrimi vertikal, humbet sigurinë e bëhet më skeptik ndaj vetvetes.

Gjuha shqipe ka një zhdërvjelltësi në të folur, është shumë burrërore dhe mjaft e bukur, ka tingull të veçantë dhe mjaft impulsive. Shqipja është vazhdim i gjuhës ilire dhe i përket grupit të gjuhëve indoevropiane, pra veçohet si një ndër më të vjetrat në Evropë dhe Ballkan. Këtu më vjen ndërmend një thënie e një mërgimtari: gjuha është e vetmja armë që vërteton që jemi shqiptar!

Studimi i shqipes është i lidhur ngushtë me interesin kombëtar

Në Shqipëri dhe diasporë gjuhësia krahasimtare ka patur arritje me vlera të mirëfillta shkencore dhe gjithnjë gjuhëtarët tanë të nderuar hedhin dritë në raportet e shqipes me gjuhët e tjera. Studimi i shqipes, përveç interesit shkencor, është i lidhur ngushtë me interesat tona kombëtare. Qëndrojmë para një fakti shumë të bukur, shumë interesant, që jo vetëm gegërishtja, por edhe gjuha e diasporës, sidomos e arbëreshëve të Italisë, tek e cila, në mes shumë barbarizmave, gjenden thesare të vërtetë, janë format më të vjetra të shqipes. Këtu kujtojmë përpjekjet gjashtëdhjetëvjeçarë të prof. Shkurtaç, si njeri i nderuar, pasionant, intelektual me interes të paparë shkencor, studiues dhe hulumtues i gjuhësisë shqiptare në tërësi dhe arbëreshëve të Italisë ne veçanti. Domosdoshmëria e ndryshimeve sa vjen e rritet. Kërkohet të kemi impenjim historik për këtë çështje, duke u bazuar edhe në përvojën e vendeve euroatlantike, pasi dhe lëvizja e lirë e këtyre njëzet vjetëve i ka zgjeruar kontaktet e shqiptarëve me

gjuhët e kulturat e popujve të tjerë.

Në këto 112 vjet të Pavarësisë Kombëtare, realiteti i shoqërisë shqiptare ka fituar qytetarinë në fushën e gjuhësisë. Ajo ka gurgulluar dhe sjell ujëra nga lashtësia e shekujve, ku shqipja ka plazmuar mendimin, ka marrë forma të personaliteteve që nga mendimi i Naimit, Çajupit, Fishtës, Mjedës, Konicës, Nolit, Migjenit, Poradecit e deri tek ai i Qoses e Kadaresë. Indiferentët dhe dembelët dhe ata që s’respektojnë parimet e gjuhës standarde shqipe, që nuk vazhdojnë rrugën e Rilindësve tanë, historia do t’i dënojë. Nga Bostoni i Amerikës, Konica shprehej: “Erdhi më në fund edhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, kohë plot shpresë! Në të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë dhe, plot me dëshirë, trimoshët e dheut tonë po përpiqen për zbukurimin e shqipes”.

I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat gjuhësore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri kur, në radhë të parë respekton vlerat e kombit tënd!

Një javë në vizitë studimore në Yerevan të Armenisë

Besoje se për çdo njëri që do ta lexojë titullin e këtij shkrimi, me një fare të drejte pyetje e parë e tij do të jetë “Çfarë kërkoni ju në Yerevan?”.

Mbas kërkimeve të mija prej vitesh në arkivat e Italisë dhe të Vatikanit më ka rezultuar që për arsye të besimit të krishterë kanë ekzistuar lidhje të forta midis popullsisë të Shqipërisë veriore, Libanit dhe Armenisë. Këto lidhje i kemi cekur në dy librat e mi në relacionet e Sospellos dhe të Buçarelit.

Një ambasador i Shqipërisë në Moskë, i cili mbulonte edhe shtetin Armeni, vite më parë kishte shkuar në Armeni, për të paraqitur letrat kredenciale Presidentit të shtetit të Armenisë. Atje i kishin rezervuar një pritje shumë miqësore dhe kishte qëndruar dhjetë ditë i shoqëruar nga Ministri i Kulturës dhe personalitete të tjera armene. Gjatë kësaj kohe atë e kishin dërguar për të vizituar edhe Arkivin Armen të Shkrimeve të vjetra. Aty i kishin thënë se ka mijëra dokumente për Shqipërinë dhe i kishin premtuar të na i jepnin të gjitha pa asnjë kufizim. Mbas një bisede të gjatë, ishin marrë vesh që të shkonin dy studentë nga Shqipëria në universitetet shtetërore të Armenisë me bursë të plotë për të mësuar gjuhën dhe shkrimin armen, për të bërë të mundur që të merreshin këto dokumente. Me gjithë kërkesën e ambasadorit, qeveria shqiptare nuk dërgoi asnjëherë student në Armeni dhe oferta bujare armene mbeti një propozim i pa realizuar. Në një bisedë miqësore me këtë ish ambasador, ai më tregoi mua historikun e kësaj vizite dhe unë vendosa të shkoj në Armeni, për të verifikuar për këto dokumente.

Ky ka qenë shkaku pse unë vendosa të shkoj në një vizitë studimore në Armeni.

VIZITA NË ARMENI

Gjatë muajit tetor 2024, unë shkëmbeva mesazhe me Arkivin e Shtetit të Armenisë dhe me disa institucione të tjera në mënyrë që vizita ime atje të mos ishte diçka rastësore, por një vizitë e programuar me kontakte të paralajmëruara. Gjatë vizitës time atje unë pata rastin të vizitoj Arkivin e Shtetit, Institutin për Studime Lindore dhe Institutin e Historisë të Armenisë pranë Akademisë së Shkencave, Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekën Shkencore të Akademisë, Muzeun Historik Kombëtar, Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, Muzeun e Genocidit armen dhe muzeun e luftës së dytë botërore.

Vizita në Arkivin Qendror të Shtetit Armen

Me datën 10 nëntor 2024 u nisa nga Tirana dhe ditën e hënë, me datë 11 nëntor 2024 në orën 09⁰⁰ u paraqita në Arkiv, sipas paralajmërimit dhe 3 bisedave telefonike që kishim bërë.

Kryem formalitetet e nevojshme dhe u futëm në sallën e kërkimeve. Sipas marrëveshjes, na pritë një punonjëse mjaft e

përgatitur nga ana kulturore dhe mjaft e sjellshme nga ana njerëzore. Kjo ishte përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe quhej Varditer Varel Grigoryan. Na ofroi çdo mundësi që mund të na ofrohej por skedarët ishin të gjithë në gjuhën armene dhe ishte e pamundur që të bënim asnjë lloj kërkimi. Ajo me durim dhe me respekt na njoftoi se nëse ne paraqesim një kërkesë me mesazh ku të përcaktohen kërkesat me specifikim se çfarë kërkojmë, ky arkiv kishte njerëz të ngarkuar që të bënin kërkimet e nevojshme, të skaneronin dokumentet dhe ti dërgonin në mënyrë elektronike kundrejt një pagese, e cila ishte e caktuar zyrtarisht nga shteti. Para se të largoheshim, ajo mori në telefon Drejtorin e Institutit për Studime Orientale, z. Aleksan Hakobyan dhe fiksuam që të takoheshim në zyrën e tij në orën 15⁰⁰.



Në Bibliotekën Kombëtare, në Muzeun Historik Kombëtar, në Institutin e Historisë të Armenisë dhe në Bibliotekën Shkencore të Akademisë


Vizita në Institutin për Studime Lindore

Drejtori i Institutit, z. Aleksan Hakobyan na pritë me përziemësi me një grup prej tre personash, punonjës të Akademisë dhe mbas prezantimit, ne paraqitëm kërkesat tona për ndihmë. Midis personave që na pritën ishte edhe një profesor, specialist i studimit krahasues të gjuhëve me emrin Harutyun Khudanyan, i cili ishte përkthyes në gjuhën Armene në këtë takim. Aty u bisedua kryesisht për mundësinë e gjetjes së dokumenteve dhe fakteve për të dy vendet tona. Ju prezantova tre libra të mija të botuara në dy gjuhë njëkohësisht (shqipe dhe italiane) ku flitej edhe për Armeninë. Në fund të bisedës shkëmbyem disa libra me autograf. Ata biseduan me Zv/drejtorin e Muzeut të Librave dhe të Shkrimeve Armene të quajtur Matedanaran, z. Vahe Torosyan. Takimi u la për ditën e nesërme, 12 nëntor, e martë ora 12⁰⁰.

Në Muzeun e Shkrimeve të Vjetra Matadanaran

Të martën, me datë 12 nëntor ora 9⁰⁰,

u futëm në muze dhe e vizitua me vëmendje dhe kënaqësi shumë të madhe. Personeli i muzeut na pritë me shumë respekt dhe u interesuan që të na shpjegonin me hollësi materialet e ekspozuara dhe rëndësinë e tyre. Na prezantuan të dhëna për shkrimin armen që nga shekulli IV dhe shkrime të ndryshme në gjuhën armene. Aty ruheshin shkrime nga shekulli IV dhe libra të shkruara me dorë nga shekulli VI. Si studiues i të drejtës tradicionale të shqiptarëve, më bëri përshtypje një libër dorëshkrim i vitit 1303, në gjuhën armene, me titull “E Drejta Zakonore”. Mbas vizitovë stendat e muzeut, në orën 11 e 30 minuta u paraqita tek sekretaria e drejtorit dhe i thash sekretares që të njoftonte drejtorin se ne kishim ardhur. Ai na pritë menjëherë. Drejtori quhej Vahe Torosyan dhe mbulonte dy sektorë të këtij institucioni, Muzeumin dhe bib-



dhe gjuhë të tjera. Sipas kësaj drejtoreshe, mijëra faqe dokumente shkruanin edhe për Shqipërinë. Koleksioni i dorëshkrimeve të Matadanaranit, është një nga më të mëdhenjtë në botë. Depozita përmban mbi 17300 dorëshkrime, 450 mijë dokumente arkivore, 3000 libra të lashtë. Mbi 14200 dorëshkrime të mbajtura në SRI janë në gjuhën armene, të tjerat janë në gjuhë të huaja - greqisht, latinisht, arabisht, hebraisht, persisht, slavishten e vjetër, etiopisht, japonisht e të tjera. Këtu gjenden shembuj unikë të përkthimit, origjina e të cilave nuk është ruajtur. Më tha se unë ato dokumente mund ti konsultoja pa asnjë kufizim. Mbas kësaj kisha kohën e qëndrimit të kufizuar, u morëm vesh që ajo të më skaneronë të gjitha dokumentet që bënin fjalë për Shqipërinë dhe të mi dërgonte me postë elektronike. Orarit të punës i kishte ardhur



liotekën. Duke i kërkuar ndjesë që shkova para orarit të fiksuar më parë dhe duke e falënderuar për pritjen filluam bisedën për shkaqet dhe qëllimin e vizitës time aty. I shpjegova me hollësi punimet e mija në arkiva dhe kërkova të më ndihmonte për të më dhënë dokumentet për Shqipërinë nëse ato ekzistonin. I kërkova të kontrolloje listën me librat e vjetra nëse janë aty dy libra në gjuhën shqipe të shkruara në vitin 1555 dhe 1574. Ai thirri aty drejtoreshën e bibliotekës, znj. Ani Petoyan, e cila ishte edhe gruaja e drejtorit. Ishte një grua shumë e përgatitur nga ana shkencore dhe njihte me kompetencë gjuhën italiane. Kjo për mua ishte një avantazh i madh sepse unë mund të komunikoj në këtë gjuhë me atë dhe ajo njihte dhe lexonte pa vështirësi dorëshkrimet mesjetare në këtë gjuhë.

Ani na dërgoi në bibliotekë dhe na ndihmoi me çfarë ishte e mundur. Edhe këtu ju dhurova libra të mi në versionin dygjuhësh. Rezultoi që në këtë bibliotekë kishte mijëra dokumente dorëshkrime të vjetra në gjuhët latine, italiane, franceze

fundi dhe ne u larguam të kënaqur dhe me përshtypjet më të mira nga ky institucion prestigjioz. Të lodhur, por mjaft të kënaqur u drejtuam për në hotel.

Ditën e tretë të qëndrimit tonë në këtë qytet, e mërkurë date 13 nëntor 2024, u paraqitëm më së pari në Bibliotekën Kombëtare ku ju dhurova disa libra të mija të shkruar në gjuhët shqipe dhe italiane. Ata kërkuar sipas kërkesës time informacion për disa libra antike, që unë po i kërkoja, por kërkimi rezultoi se ato që kërkoja nuk gjendeshin në këtë bibliotekë. Duke më falënderuar, më dhanë dokumentin për dorëzimin e librave dhe një fletë falënderimi të firmosur nga drejtoresha e kësaj biblioteke, për dhënien pa pagesë të librave nga ana ime.

U larguam nga biblioteka dhe u paraqitëm në Muzeun Historik Kombëtar për ta vizituar. Ishte një ndërtesë imponante, ndërtuar me mermer dhe me një arkitekturë mbresëlënëse e vendosur në qendër të qytetit në krah të godinës qeveritare ku ishte e vendosur kryeministria.



Shqipëri e Kosovë bëhen bashkë në një ditë!

SHPALLEN TË LUMTUR DOM GJON GAZULLI DHE ATË LUIGJ PALIQ

Drejt Lavdisë së Altarëve

Kush mund ta harrojë 5 nëntorin e vitit 2016, kur në Kishën Katedrale të Shkodrës, kremtohet Mesha për Lumturimin e 38 martirëve shqiptarë që dhanë jetën e tyre për Fe e Atdhe gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri? Një apoteozë e vërtetë me besimtarë që populluan Shkodrën atë ditë feste, duke lartësuar virtytet e bijve të këtij populli, që me shembullin e tyre heroik, realizuan fjalët profetike të filozofit dhe teologut Atë Anton Harapi:

“Çdo ndërtëse i vihen themelet në dhe. Edhe në varr, prandaj, në hijshëm, duhet të jemi gur e themelit të njaj binaje të cilën sot e quajmë Shqipni”. (Vlerë Shpirtërore, Botues “Hylli i Dritës”, Tiranë 1994).

Kaluan tetë vite nga ajo datë historike, dhe Kisha Katolike, i shton listës së të Lumëve edhe dy shqiptarë të tjerë: Dom Gjon Gazulli dhe Atë Luigj Paliq. Në fakt, nëpërmjet një komunikate, më datën 20 qershor 2024, Selia e Shenjtë shpalli dekretin e Dikasterit për çështjet e shenjtërve, përmes të cilit Ati i Shenjtë, Papa Françesku, dekreton dhe autorizon Lumnimin e

Atë Luigj Paliqit dhe Dom Gjon Gazullit. Meshën solemne dhe Ritin e Lumturimit do ta kryesojë, më datën 16 Nëntor 2024, në Katedralen e Shkodrës, i dërguari i posaçëm i Atit të Shenjtë, Papa Françesku, Eminenca e Tij Kardinali Marcello Semeraro, Prefekt i Dikasterit për Çështjet e Shenjtërve. Parashikohet të jetë i pranishëm, përveç autoriteteve të tjera fetare e civile nga Shqipëria e Kosova, edhe Kardinali shqiptar Dom Ernest Troshani.

Zadrime e intelektualëve dhe shenjtërve

Dom Gjon Gazulli lindi në Dajç të Zadrimës (Lezhë), më 26 mars 1893. Dhe, siç tha Kardinali shqiptar dom Ernest Troshani, në meshën që kremtoi në Blinisht, më 6. 11. 2016: “Zadrime është një popull që ka dhuruar shumë”.

Pas shkollës fillore në vendin e tij, filloi studimet në Seminarin Papnor të Shkodrës.

Në vitin 1912 vazhdoi studimet në Romë, më vonë në Francë, e pastaj edhe në Austri, por jo gjithmonë vetëm për arsye studimi, por edhe për arsye shëndeti.



U shugurua meshtar më, 4 gusht 1919.

Qe një kundërshtar i vendosur i qeverisë së mbretit Zog, që diskriminonte zonat e Dukagjinit, të Pukës dhe të Mirditës, zona

tërësisht katolike.

Ngulmimi i tij për të dënuar një regjim të tillë pati pasoja: më 26 dhjetor 1926 u arrestua. Mjaft shpejt,

Mbas kësaj vizite, u paraqitëm në Akademisë së Shkencave, në Institutin e Historisë së Armenisë tek Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Drejtësisë Prof. Edgar Hovhannisy. Biseduam gjatë për problemet e të dhënave për Shqipërinë në dokumentacionet që ata kishin dhe mbas një bisede të frytshme dhe miqësore u ndamë për të shkuar në Bibliotekën Shkencore të Akademisë. Në këto takime gjithnjë ishte shoqëruesi dhe përkthyesi ynë Prof. Harutyun Khudanyan, i cili ishte organizatori i këtyre takimeve.

Në Muzeun e Gjenocidit Armen

Ditën e enjte, me datë 14 nëntor 2024 shkuam për vizitë në muzeun e gjenocidit ndaj popullit armen. Edhe ky institucion ishte mbresëlënëse. I ndërtuar me mermer dhe i vendosur në majë të një kodre nga ku mund të vështroje të gjithë qytetin Yerevan, kishte një obelisk rreth 30 metra të lartë. Në stendat e muzeut ishin të demonstruara krimet dhe barbaritë që ishin kryer ndaj popullit të pa mbrojtur dhe të pa fajshme të Armenisë. Aty deklarohesh se në gjenocidin e vitit 1915, pushtuesit otoman kishin vrarë një milion e gjysmë armen. Fotot dhe dëshmitë e panumërta krijonin një tablo të qartë të këtij gjenocidi të tmerrshëm. Armenët tash mbi njëqind vjet kërkojnë që të njihet zyrtarisht ky gjenocid dhe të kompensohen për dëmet e shkaktuara. Kërkesa vazhdon edhe sot e kësaj dite por asnjë gjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Mbasi vizituam Muzeun e Gjenocidit u paraqitëm në Bibliotekën shkencore të Akademisë së Shkencave. Në fillim aty takuam Prof. Zohrab Gevorgyan. Mbas bisedës me profesorin e nderuar u paraqitëm në Bibliotekën Shkencore të Akademisë.

Kjo bibliotekë më impresionoi, sepse

aty kishte, sipas asaj që ata më thanë, tetë milion libra shkencore në të gjitha gjuhët e botës. Ju dhurova librat e mija që i kisha sjellë për ti dorëzuar në libraritë e këtij vendi. Ata më bënë një dokument të tipit fletëhyrje dhe më pajisën me një kod, me të cilin mund të shikoja librat e kësaj biblioteke nga shtëpia ime pa qenë nevoja të shkoja aty. Orari zyrtar kishte mbaruar dhe ne u larguam për në hotel.

Në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës dhe në Muzeun e Luftës së Dytë Botërore në Yerevan

Ditë e fundit të qëndrimit tonë në Armeni, me 15 nëntor 2024, shkuam për vizitë në qendrën ndërkombëtare të kulturës. Ishte një institucion gjigand i mbështetur në shpatin e një kodre, me sheshe të zbuluar me lule dhe me statuja gjigande, me një arkitekturë të mrekullueshme dhe i gjithi me mermer të skalitur. Ata që kërkojnë të njihen më mirë me këtë qendër mund të kërkojnë në google serch me këtë emër “Cafesjian museum-foundation Yerevan”. Për tu ngjitur deri në majë, ishin njëmijë shkallë dhe ngjitja atje për njerëz të moshuar dhe me probleme kardiale siç isha unë ishte një gjë e pamundur. Në fillim të këtij institucioni ishte një hyrje dhe brenda kishte shkallë lëvizëse me korrent, të cilat të mundësonin të ngjiteshe nga njëri shesh pushimi tek tjetri pa u lodhur. U ngjitëm me ndihmën e këtyre transportierëve deri në pikën më të lartë të mundshme, por jo deri në majë të kodrës. Ndërtimi i kësaj qendre kulturore ishte ndërprerë pa u mbaruar për shkak të ndryshimeve politike atje dhe hekurat e vendosura me stafa, me lartësi deri në gjashtë metra mbi themelet e përfunduara ishin të ndryshkura nga mos betonimi. Tani opsioni i fundit ishte ngjitja me këmbë në shkallët prej betoni deri në majë të kodrës. Atje ishte një shesh i

madh prej betoni i vendosur mbi kolona gjigande betoni dhe poshtë këtij sheshi kalonte autostrada me dhjetë korsi. Në këtë shesh ishte i vendosur një tjetër obelisk mbi pesëdhjetë metra i lartë. Nga kjo pikë mund të shikoje qytetin e Yerevanit si në pëllëmbë të dorës. Më erdhi shumë keq kur u ngjita në krye dhe pasqy që ky kompleks i mrekullueshëm kishte mbetur i pa përfunduar për shkak të ndryshimit të sistemit politik. Fotoja e dytë e tregon gjendjen e pjesës fundore të këtij kompleksi gjigand.

Rreth pesëqind metra më larg, po në majë të kodrës ndodhej një park gjigand me pemë dhe me lodra pa fund për fëmijë. Kishte parcela me lodra ku pa ndonjë vështirësi mund të luanin deri në një mijë fëmijë pa asnjë problem. Ishin ndërtuar dinosaure të bukur me madhësi deri në gjashtë metra, të cilat krijonin një panoramë të këndeshme për fëmijët, por edhe për të rriturit.

Në mbarim të këtij parku, por në vijimësi, ishte i vendosur muzeu i luftës së dytë botërore. Ishte ndërtuar në formën e një obelisku rreth njëzet kate i lartë me një statujë të një luftëtari në majë midis një sheshi të madh ku ishin ekspozuar pajisje ushtarake: armë, raketa, avionë, tanke, topa e të tjera.

Në brendësi muzeu kishte ekspozatë që tregonin luftën dhe qëndresën e popullit armen. Më së pari vizitori duhet të përkulej para memorialit të të rënëve për liri pastaj të vijojë vizitën në pavionet e ndryshme të këtij muzeu. Ata na thanë se, në luftën e dytë botërore kishin marrë pjesë 49 batalione armene, të cilët kishin shkuar nga Yerevani deri në Berlin. Në hartat e vendosura ishte shënuar dukshëm rruga e përshkuar nga kjo ushtri deri në Berlin. Në ballinën e një pavijoni ishte hapur një galeri ku ishte vendosur një maket i sheshit kryesor të Berlinit dhe Raishtagu

gjerman i bombarduar dhe shkatërruar nga ushtria ruse ku armenët kishin kontribut të dokumentuar. Galeria ishte vendosur prapa një xhami të madh rrafsh me murin dhe ishte e ndriçuar. Dukej si një pamje televizive tredimensionale. Ishte mbresëlënëse. Në njërin nga sallat ishin vendosur fotot e tradhtarëve dhe bashkëpunëtorëve të pushtuesve për të treguar se ata kishin gabuar shumë rëndë dhe ishin të dënuar publikisht. Të tjera pavijone ekspozonin heronj dhe luftëtarë të shquar dhe relike të tyre. Midis këtyre ishte një gjeneral, i cili kishte marrë pjesë në luftën e dytë botërore dhe kishte vdekur në vitin 1982. Ai ishte dekoruar dy herë me titullin “Hero i Popullit”.

Armenët krenoheshin për të kaluarën e popullit të tyre, për luftën, qëndresën dhe sakrificat që kishin kaluar.

Vizitës tonë në Yerevan i kishte ardhur fundi dhe ne u drejtuam për në hotel, për tu larguar të nesërmen në mëngjes herët për në Shqipëri.

Ishte një udhëtim mbresëlënëse me veprimtari të dendur i realizuar në pesë ditë, por që nëse e kemi të mundur, kemi dëshirë të shkojmë përsëri për të marrë më shumë informacione për këtë komb të lavdishëm.

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata persona që më pritën dhe më ndihmuan pa rezervë në misionin tim.

Falënderoj edhe Profesor Harutyun Khudanyan, i cili më shoqëroi dhe më përktheu me shumë vëmendje bisedat me kolegët e tij. Ai ishte edhe organizatori kryesor i takimeve të mija.

Gjithashtu më duhet të falënderoj personelin shumë të sjellshëm të hotelit “Dynasty”, për ndihmën që na dhanë dhe për informacionet.

**Mark dhe Prenda Palnikaj,
Tiranë më 18 nëntor 2024**

◀ saktësisht më 2 janar 1927, u dënua me vdekje dhe, më 5 mars të po atij viti u var.

Eshtrat e tij prehen në varrezat e Rrmajit në Shkodër dhe varri i tij tashmë është cak lutjeje për shumë shtegtarë, të cilët e vlerësojnë shenjtërinë e dom Gjonit. Janë të

Ati. Gjithë udhën u luten të dy me za të naltë, por unë muejta me vu ore se zani i Atit dridhej, nësa zani i famullitarit tingëllonte i qetë e i qartë. Një trimni kaq të madhe kurrë së pash në jetë time.

Kishim arrijtë te vendi i vdekjes, në Fushë të Druve. Aty ishte shtylla e vdekjes.



panumërta dëshmitë e atyre që janë shëruar dhe kanë përjetuar mrekulli me ndërmjetësinë e dom Gjonit. Edhe personalisht, jam dëshmitar i disa shërimeve që kanë ndodhur duke u lutur tek varri i tij. Fama e shenjtërisë së tij ka nxitur popullin e Zotit dhe Kishën Katolike që të ndërmarrin për të atë që quhet procesi dioqezan për ta shpallur të Lumtur dhe të shenjtë. Lutemi me gjithë zemër që, siç ndodhi me 38 martirët e regjimit komunist në Shqipëri, ashtu edhe dom Gjoni të shpallet i Lumtur, duke u lartësuar kështu në nderin e Altarëve!

Ja si e përshkruan ekzekutimin e shërbëtorit të Hyjit, oficeri i ngarkuar për varjen e tij, në një intervistë me revistën gjermane "Korrespondenz des Priestergebetsve", botuar në "albemigrant": <https://albemigrant2011.wordpress.com/2017/02/15/daniel-gazulli-martiri-i-atdheut-dom-gjon-gazulli/>:

"Ishte ora 11 para mesnate. Udhët e Shkodrës ishin ende të rrahuna prej njerëzish, pse ishte Bajram. Dhash urdhën të thirrej famullitari Gázulli n' oborr, pse donte me fole me të Ipeskhvi. Gazulli zbriti poshtë. E kuptoj çfarë do të ndodhte.

Një françeskan me Sakramend ndej para tij (At Martin Gjoka, shënim i D. G.). ... Françeskani kishte mbete pa gojë. Famullitarit Gázulli nuk i ndërroi aspak ngjyra e fytyrës... Ai i kapi dorën Atit e i tha: "Pater Martin, tash ke me më Rrëfye". Ati iu lut ushtarëve të mbledhun për rreth me u largue. Mbasi na nuk u larguem, Ati i tha: – "Dom Gjon, Rrëfeju, pra, latinisht a italisht". – "Jo, Pater, i përgjegjet Gázulli, të mbramin Rrëfim due me e ba në gjuhë të Nanës". E kështu Ai u rrëfye në sy tanë. Na, Muhamedanët, pak marrim vesht kësi sendesh, por mëkat nuk dëgjuem prej gojës së tij. Mandej i dha Ati një bukë të hollë, të bardhë, e rrumbullakët, që e kapërdini me një përshpirtinë të madhe. Ai u dukte se po shndritte krejt fytyret.

Tash u çil dera e burgut, e u nisëm. Ushatarët ishin para, mbrapa e në të dy anët, ma shumë se kurrë. Në mjedis ishte Ai dhe

Magjypi ishte gati me litar në dorë. Një dritë elektrike e shndritte thektas famullitarin në fytyrë. Ai nuk dridhej aspak. Edhe mue më kishte kapë frika. Mue më ishte dashtë me përcjellë edhe të tjerë te ky vend i mjerë, por tash ishte tjetër. Unë kisha gati si një frikë para qetësisë së këtij Prihti. Ai ishte me të këputme i pafaj. Këte e dijsim të gjithë. Por, urdhni! Unë, sikur asht zakon, i lash fjalën e lirë. Por ma mirë mos ta aq të fortë, e me fjalë të drejta e që të këputshin zemrën, sa që mue përnjimend më kapi frika. E ta kisha lanë me shkue gjatë me fjalë, kishte muejtë të gjithëve me na ba me u kthye prej vetit. Mue më duhej me mendue për përgjegjësinë teme. E i thash



shkurt: Zotni, s'duem me ndje predke! Foli fjalët e mbrame. Mjaft!

Atëherë Ai çoi zanin edhe ma e tha: Vetë po vdes i pafaj. Rroftë Krishti, Mbreti ynë! Rrënoftë Shqipnia dhe Shqiptarët e vërtetë".

Na ishim të gjithë të përmalluem fort. Lexova vendimin e dekës. I qe veshë një këmishë e bardhë. Magjypi ia vuni vjekcën e konopit në fyt e i hoq shkambin nën kambë. Ai ishte i vdekun!– Kështu foli kapiteni. Ishte dita e 5 marsit 1927".

U realizua edhe në dom Gjonin ajo fjala e Zotit thënë në Veprat e Apostujve: "Na duhet të kalojmë nëpër shumë vështirësi për të hyrë në Mbretërinë e Hyjit". (Vap. 14, 22).

Dy fjalë për Atë Luigj Paliq

Atë Luigj Paliq lindi në Janjevë (Kosovë), në Arqipeshkvinë Shkup-Prizren, më 21 shkurt 1879.

Pas shkollë fillore në vendin e lindjes, u transferua në Shqipëri, ku hyri në familjen rregulltare të Fretërve Minorë, në Kuvendin e Troshanit (Lezhë).

Në Troshan bëri noviciatin. Vazhdoi studimet filozofike në Itali gjatë viteve 1896- 1901.

U shugurua meshtar, më 21.09.1901. Pas shugurimit shërbeu në Kosovë, në famullinë e Pejës dhe të Gllogjanit, si edhe në shenjtëroren e Shën Antonit në Gjakovë. Ndërroi emër nga Mati në Luigj, sepse ishte shumë i prekur nga jeta e Shën Luigj Gonzagës.

Pas shugurimit u ndal në Romë edhe për dy vite të tjera për studime pas-universitare.

Gjatë viteve 1905-1907 qe famullitar në Arqipeshkvinë e Shkodrës.

Gjatë viteve 1907-1912 u emërua rektor i shenjtërores së Shën Antonit të Gjakovës (Kosovë).

U martirizua në Janosh afër Gjakovës, për faktin se nuk pranoi të bëhej prift ortodoks, më 7 mars 1913 dhe

kundërshtoi marrëveshjen e tij me serbët për të ashtuquajturin "bashkim personal të Shqipërisë me Jugosllavinë".

Ishte një njeri i vendosur. «Luftëtari i dritës provon një lloj tmerri përpara vendimeve të rëndësishme. "Kjo është shumë e madhe për ty", i thotë një mik. "Ec përpara, sytë të mbur", i thotë një tjetër. Dhe dyshimet e tij sa vijin e rriten. Pas disa ditësh plot ankth, kridhet në prehje shpirtërore brenda në çadër, ku e ka zakon të ulet për të medituar dhe për t'u lutur. Ai e shpie veten në të ardhmen. Shikon se kush do të përftojë e cili do të humbasë nga qëndrimi i tij. Ai nuk dëshiron të shkaktojë vuajtje të kota, por nuk do as të braktisë rrugën. Atëherë luftëtari e lë vendimin të dalë vetiu. Nëse duhet thënë po, do ta thotë me guxim. Nëse duhet thënë jo, e bën pa iu dridhur qerpiku». (Pjesë e shkëputur nga Manual i Luftëtarit të Dritës i Paulo Coleho).

Më 23 gusht të vitit 2023, patëm fatin të shkojmë në shtegtim për t'u lutur tek varri ku prehet Atë Luigj Paliq në Zym, të shoqëruar nga aktivistja e Kosovës Marte Prekpalaj (aktualisht Kryetare e Këshillit të fshatrave të Hasit) dhe mësuesja e muzikës Lidija Nushi.

Atë Luigj Paliqi (Palaj) dhe dom Gjon Gazulli janë të vetmit martirë që i takojnë kohës para komunizmit.

E bekojmë Zotin për këtë lulëzim shenjtërie që e ka bekuar popullin tonë të shumëvujtur!

16 Nëntori 2024, në Katedralen e Shën Shtjefnit në Shkodër, vulos përfundimisht një lidhje të re me vlerat, një lidhje e themeluar në gjakun e martirëve. Edhe një herë, bëhen bashkë në një ditë, Shqipëria dhe Kosova.

Përgatiti:
Nikolin Sh. Lëmezhi



VIRTYTET E MËDHA NË VEPRËN E TIJ POETIKE

FRYMËZIMET FILOZOFIKE, FIGURA REALE E IMAGJINARE, KU E PËRCEPTON BOTËN NË SHUMË DIMENSIONE
RECENSION PËR LIBRIN POETIK, „THIKAT E MLLEFIT“, NGA AUTORI BRAHIM IBISH AVDYLI.

Kam lexuar e rilexuar vëllimin e ri poetik që më solli për recensentë poeti Brahim Avdyli dhe e prita me kënaqësi, dhe pashë që autori dëshiron rrugëtim me horizont gjithpërfshirës dhe me motivin duke hapur shumë dyer, dritare, shtigje, ndaj shihet dashuria e tij e zjarrtë për fjalën e vargun, por dhe flet për zhbërjet, helmet e dashurisë që tashmë duken sheshazi, fatkeqësisht kudo, hijet, pushtetin e vdekjes, për pranverat, flukamat, thikat e mllefit, shpenzimet, trinitë, parantezat, alergjinë, metaforikën, tragjikomedinë, apokaliptikat, meloditë e trishta, antitezat, konglomeratet, shpresat etj.

Ndaj, gjithçka që gjeta dhe solla deri tani për temat e përzgjedhura, e bëjnë autorin poliglot të fjalës ku jeta, merr frymë me frymën e poetit Brahim Avdyli, i cili gjendet në rrafshin e vet brenda poetikës por dhe letersisë shqipe pasi zbulon visare duke ndezur drita të veçanta për ta soditur e sjellë botën në poezi.

Kjo do të thotë, „je i thjeshtë në madhësi“ ndaj zotëron filigramin e artit poetik. Fisnikëria dhe dinjiteti njerëzor, janë ndër të paktat virtyte që koha nuk mund ti zhdukim asësi.

Thuhet se filozofitë zbehen, besimet ndjekin njëri-tjetrin ose dhe ndryshojnë por ajo që është e bukur e tillë do të mbetet, por është dhe posedim për gjithë përjetësinë.

Ndaj kjo që u shkrua më lart besoj se i përshtatet mjaft mirë Brahimit pasi në krijimtarinë e tij gjen vlerat më të larta të letersisë bashkëkohore shqiptare e sidomos të artit poetik në gjithë hapësirat shqipfolëse, ku ka lëvruar këtë zhanër letrar që në rininë e tij të hershme.

Brahimi është poet e shkrimtar, por shkon përmes shembullit personal në gjithë krijimtarinë e tij të hershme apo të vonë të cilën e lëvron përmes vlerash duke u kthyer burim frymëzimi për brezat e së ardhmes.

Pa dyshim se ai i ka vënë detyrë vetes dhe e zbaton me përpikmëri përsosjen mjeshtërore, e vjen si frymëzim për lexuesit shqiptarë, dhe i gjej te çdo fjalë a varg të krijimeve të tij duke u shprehur përmes thellësisë së mendimit, fuqisë filozofike e fjalës së mirë menduar, dytësisë së mendimit e finesave të kuptimit dhe i shpreh fuqishëm përmes metaforave pikante ku lidhen ngushtë me njëra-tjetrën.

Brahim Avdyli vjen si rrjedhë e letersisë shqiptare, e citoj kështu pasi në rrjedhën e tij krijuese përfshin fjalën e artin si arsyetimin e thjeshtë se „poezia është art i atij që di ta lexojë poezinë“.

Do sjell disa nga temat mjaft interesante që përmblan ky vëllim poetik: „Helmet e bukurisë“, „Pranvera e shkëmbuar“, „Thikat e mllefit“, „Trinitë e qënies“, „Parantezat e gjykimeve“, „Alergjia e shkatërrimit“, „Tragjikomedia e ferriit“, „Apokali-ptika e fjalëve“, „Antiteza e dijes“, „Nuk më braktisë shpresa“, etj. Këtu, po e marr një pjesë të poezisë:

„ 3.

*Zotin e thërras
por ma sjellin të veshur jevgjit,
njëmijë vrime ndjenjash shtazarake
i paska prej ballit të çështjes
e deri pas vetes,*

*më dukej
se isha i dërguar nga Zot-Mërkuri
në tragji-komedinë jetike e të përkohshme*

*e asgjë të ligë nuk guxoj që ta bëj
që të më thërrasin
legjendar përjetimesh!...*

(Poezia „JAM MËSUAR ME ZHBËRJE“)

Fuqia e fjalës zë vend në çdo varg të kësaj poezie, krahas asaj shpirtërore dhe ngre krye mes shigjetave të kohërave duke u kthyer në qëndresë poetike e formësuar në kështjellën letrare atë çfarë i ligjëron e kaluara shumë shekullore e të sotmes, pra çka përfaqëson poeti dhe e vë në dilemë me botën dhe veten.

Çfarë kërkon poeti dhe çfarë gjen, me varg transparent krahason dy botë të qenësishme në një të vetme, sa vështirë bëhet dallimin mes botës kafshë dhe njeri e shtjelluar, e tëra hipokrizi. Ndaj fjala e vargu janë lidhur pazgjidhshmërisht me shpirtin e poetit, duke kaluar furtuna, por i duruar. Lumturitë e munguara, bota vetmitare e poetit, nuancat e emocioneve të cilat nuk përtypen assesi nga një lexim pa analizë.

Brahimi, është kritik letrar, ndaj është mësuar me skanerin dhe energjinë purifikuese dhe shpesh ndryshon frekuencat e ajrit me argumente ilustruese.

Kështu që poeti shprehet se është mësuar me zhbërjet, duket haptazi se, ai është përballur me forcën e natyrës e cila i ka dhënë poetit nga forca e saj ndaj, jo më kot thuhet se prej forcës merr forcë edhe kur të fusin në burgjet e paqena, të paqena kur ndodh e liga, e nga pësimet shuhet vorbulla e shpirtit.

Mbushur imazhe e tema të shumta që duket aq e vështirë të veçosh ndonjë, pasi brendia e tyre lë të nënkuptosh se ka aritur univerzalizimin me vlera të veçanta ku ekziston padyshim ajo lidhja e ngushtë e hermetizmit mbi fenomenet e shumta të ndodhura në harkun kohor të jetëgjatësisë së autorit.

Për poetin padrejtësitë janë llava ku harbon dhe përfshin honet e shpirtit dhe përcëllon botën ku gjendesh, aty mes flakërimave e shpresat e pritura, si kundër edhe poezinë e vendos po në të njëjtën drejtëz a baraspeshë “Në vend të Zotit qenka kryemadhi i zoti i djajve”, vendos gjithashtu mirësinë e zotit me dëmin e madh të pësimeve në vorbullën e shpirtit, në formën më filozofike të mundshme ku gjithçka thotë Brahim vjen nga pika e mendimit.

„ 4.

*Gjak pabesie
rrugëve të botës*

*edhe për gjëra të liga
që kurrë nuk i kam bërë
prapë po i laj,*

*shprehimisht e kam pranuar
fuqinë kozmike
e fëmijët e vegjël
i kam mbajtur mbi vetull*

*prore kam ruajtur
për bardhëzimin e vargjeve
me ngjyrën boreane të maleve*

*e askujt borxh
nuk i mbetem
frymëmeve për të nesërmen...“*

(Poezia „THIKAT E MLLEFIT“)

Kjo poezi mban dhe titullin e librit.

E fuqishme në tërësinë e saj dhe thellësisht tronditëse dhe bartëse e dhembjeve të jetuara e pa të jetuara jo vetëm të autorit, por një pjesë të madhe të shoqërisë dhe shoqërive dhe ndjehet si përfaqësuese e kohërave të vështira.

Ama, duket se në këtë libër shkruhen tmerri a konvergjenat që bien njëra pas tjetres si p.sh. pabesia si ligësi e egër apo shpifjet mbi qenien njeri. Duket se poeti është besimtar te natyra e gjithësia ndaj përkushtohet me mish e shpirt pasi fëmijët i mban mbi vetull me tërë forcën dhe energjitë duke ndjerë përgjegjësi njerëzore.

Shpirti i tij i badhë, thotë fjala e vargu se ngjan me ngjyrën boreane të maleve, duket se gjoksin e tij, fuqishëm ia kthen erës.

Kur të krijuarit a të shkruarit bëhet nga pena e stërvitur dhe e talentuar, bën t'i përzgjedhësh kaloritë që kthen si vlerë për një jetë të shëndetshme, pos që zbukuron artin e fjalës me fjalët e shpirtit, ndonëse rëndesa është e dukshme. „Lum kush di ta ushqejë shpirtin se ju bëhet vend edhe të tjerëve“, kjo thënje biblike sikur gjen vend në poezitë e këtij vëllimi poetik, dhe natyrshëm lind ky binom mes poetit dhe lexuesit, ndaj ky libër është shkruar me gjakun e shpirtit dhe do të ju shërbejë kryekëput shpirtërave njerëzor.

Poeti, ashtu e ka përballuar mes sfidave një jetë si në varg apo një shumicë e shoqërisë duke ndjekë shtegëtimin e tij pasi sillat si kujtesë dhe përkujdesje, që ta kemi përparësi zhvillimin mendor, dhe ngjan sikur një njeri vjen para nesh i lindur mes valëve dhe shqetësimeve të mëdha, dhe vetëm për t'u sprovuar ndërkohë sjell imazhe të fuqishme që mposht ligësitë e pabesitë dhe përcjell ndjenja kolektive që rrjedh nga përvoja e ekzistencës dhe i përcjell njëkohësisht mesazhe popullit të vet të shumë vuajtur ku ndërlidhet pikëllimi si binom i poetit me lexuesin.

„ 1.

*Vargu qarkullon
nëpër lugje e kodra të djallëzisë,*

*aty lodron
oligarkia e krijesave
të përçudshme*

*fishkëllon me të madhe
fundosjen e mileniumeve,*

*digjem nga dhembja
në pamundësinë e kuptimit.*

2.

*Më del tymi
nëpër kapakun e mendjes-*

rrjedhje me mjegullnajë

*e njeriu dergjet
nëpër dridhjet e mosbesimit,*

*me shpërfillje
na zë kudo alergjia e shkatërrimit...“*

(Poezia „ALERGJIA E SHKATËRRIMIT“)

Poeti është gjithnjë në kërkim të përsosjes së shprehjes, ndaj dëshmon fuqi poetike në çdo varg, strofë e poezi ndaj godet me tehun e fjalës peshuar mirë.

Shpesh e ndeshim filozofinë e goditjes në nivelin e lartë të mendësisë së intelektit, ku bën të rrebelosh ndjenjat për frontin që hap autori me nocionet si „nëpër kodra e lugje të djallëzisë lodron oligarkia e krijesave të çuditshme“.

Dihet që, opsioni më i mundshëm dhe real është goditja për t'i dhënë vlerë fjalës por dhe ngjyrë e dritë vargut në ndërtimin e veprës por dhe jetën njerëzore. Sikur të motivon sintonia me hapësirën e të menduarit në gjithë labirintet me hermetizmin që autori sjell në varg, strofë a poezi.

Autori ka përjetuar brishtësinë e shekullit dhe ka ndërtuar oazën e tij duke qenë se efekti kohë është edhe ilaçi më i mirë e mësues inspirues, ndaj është origjinal brenda individualitetit të tij krijues dhe tërësive universale në një proces të gjatë përmes psiko-filozofisë.

„Më del tymi nëpër kapakun e mendjes“, kur vorbullohen fjalët e vargu merr flakë, gjëmon përmes fjalës qan dhe i këndon shpirti njëkohësisht për brengat dhe përçapjet që rrinë aty struktur, diku skutave të shpirtit pasi prej hijes, territ verbon dhe qiellin blu, vërshojnë turbulencave të papritura ku dhe ajri mungon, dhe duket se shëmti e errët i bie horizontit dhe epokat mbjellin terr mbi dritën.

Autori artikulueshëm vigjilon personalitetin dhe botën që e rrethon.

Autori vjen në perfeksion në pikëpamje të interesave motivuese por dhe tematike, e kjo bën autorin të ketë fron por impulset e nervit nuk gjejnë dot qetësi.

Ky vëllim vjen si testament që kërkon „ringjallje a rizgjim“ nga motet e hidhëta të shëmtisë të epokave dhe imazhet shër-

bejnë për thellim studimi në këndvështrimin poetik dhe krejt dimensionet universale dhe eksplorimit nëpërmjet përjetimit, vargut që përbën të magjshmen duke e hasur kudo në varg, strofë e poezi.

Poezia e Brahimit, është plot frymëzime filozofike, figura reale por dhe imagjinare, përjetime personale, ku percepton botën në shumë dimensione dhe përcjell porosi e mesazhe por edhe unitet.

„ Asnjëherë nuk më lë
shpresa e mbjellë në shpirt

të mbijetuarit e dhembjes
i sjellë nëpër meditimet e zemrës,

mendja lart e zemra është në mes
pa e pyetur edhe atë
nuk merret vesh çështja e botës,

atje e kam mbjellë kaherë
energjinë magnetike të mbijetesës

AI është Zoti i Madh
i të gjitha materieve dhe imaterieve
që shenjëzojnë gjithësinë

kur i dëgjojmë zërat e trishtueshëm
prej botës paralele
në botën e përkohshme
e prekim zemrën

dhe e dimë mirëfilli
se shpresat kurrë nuk shuhen!“

(Poezia „NUK MË BRAKTISË SHPRESA“)

Më pëlqen ta citoj sërish bukurinë e vargut dhe thjeshtësinë në dukje ndonëse mjaft estetike, ku skalitë bukurinë e vlerave, ndaj s'i shuajnë dot vitet as shekujt. Kaq këndshëm i shijoj këto vargje në tërësinë e këtij libri, pasi thellësinë e mendimit arrin te caku i autorit ku zotëron eklipsi mes gjenive me drejtësitë dhe ab-

surditetin. Me xhevahirët mund të bësh stoli të bukura, ama një ditë iu bie shkëlqimi, kurse fjalët e fuqishme që burojnë nga guvat e shpirtit artistik të Brahimit, bëhen monumente kulture për të realizuar ëndërrën në përjetësi.

Lexone këtu mesazhin madhështor që vetë e përcjellë poeti në poezi, prandaj është aristokrat i fjalës së përzgjedhur me mjeshtri si ilaç i trurit që ua transmeton brezave.

Vargu ka peshë, ka art dhe vlerë, ka mesazh e përjetim plot ndjenjë dhe përcjell emocion.

Në vëllimin poetik „THIKAT E MLL- EFIT“ gjendet i gjithë universi i shpirtit krijues, prestigji i shenjëzuar ndër kodet semantike i gjuhës së ashpër dhe frymës së shpirtit dinjitetshëm njerëzor, aty ku parafytyron portat e ferrit monstruoz, aty mes demonëve të veshur hijshëm me petkat e mrekullueshme të mashtrimit, gjen kurajon për të përcjellë mesazhe të bardha shprese dhe për ta çuar deri në fund misionin e tij të shenjtë brenda gjithë kolo-riteve.

Ky stil brehtian me ide të qarta, ku të shëmtuarës i vë fytyrën e mospëlqimit dhe përballet me kundërshtitë përmes mesazheve përçuese.

Brahim Avdyli ka kultivuar shprehje të pastra artistike të mendimit filozofik në përpjesëtime të përkryera në sensin e artistit poet brenda lëmisë të letërsisë shqipe. Poeti kërkon përmirësimin e rendit jetik, bën thirrje për ndërgjegjësim të mendimeve, ndjenjave apo veprave të pastra përballë anti vlerave.

Autori paraqet karakter e virtyte të larta në raport me zhvillimet shoqërore.

Ndjenjat dhe kënaqësia estetike e përbërjes shumë dimensionale është thelbi dhe vizioni poetik tek Brahim Avdyli ku modelon universin në unison me botën që e rrethon, pasi aq ndjeshëm artikulon emocionet dhe tensionin që shkakton përmes vargjeve e bën funksionale me



konstruktin poetik.


Kështu që, uroj pafund suksese Penës së ndritur të autorit, të ketë sa më shumë frymëzim për krijime të shumta brilante nga gurra e pashtershme dhe muza e poetit Brahim Avdyli.

Dritë dhe refleksion në krijime dhe botime të reja plot vizion për një botë në zhvillime të reja, e sa më lehtë e këndshëm për lexuesin.

Udhë e mbarë plot bardhësi librit.

„Gurrë e pashtershme për ju poet, është frymëzimi“...

Prenda Sejdia, Lezhë 2024



LAMTUMIRE NDUE MICI

Të nderuar të pranishëm!

Të nderuar familjarë!

Jemi mbledhur sot për ti dhanë lamtumirën e fundi, bashkë familjarit dhe birit tuaj, të dashur, mikut tonë çmuar, bashkëveprimtarit dhe aktivistit shoqëror të pa përtuar, kaçurrelit hirplote më thinja fisnike te argjendta, pinjollit të shquar të bukurisë mashkullore të Shoshit, njeriut të mirë e bujarë, Ndue Mici.

Sot mori rrugën për amshim pas një shtegtimi 85 vjeçare Ndue Marash Mici, birë i denjë i Palajve, orë – mëdhenj të Shoshit Historik.

Kulla e vjetër më unakë burrërie, bese e bujarie e Mic Doshit të Palajve humbi sot një nga trarët ballanik që i bënte nderë jo vetëm kësaj dere të mirënjohur, por Palajve Shoshit dhe pse jo gjithë Dukagjinit.

Ndue Mici lindi nënë hije të Rasës së Palajve, u rrit mes një bote epike dramatike, e cila la gjumë të thella në formimin e tij qoftë si karakter, qoftë si patriot dhe njeri me zemër të madhe.

Mësimet e para i mori në Shtatëvjeçarën e Palajve një nga shkollat më të moçme e ma me traditë të krejt Dukagjinit. Mësimin e mesme thelloj në Shkodër dhe gjatë gjithë jetës stolisi mendjen me lexime, filozofike, letrare, historike, psikologjike literaturë të ndaluar dhe ashtu të quajtur te zeze dhe dekadente në kohën e dik-



taturës.

Ndue Mici ishte mik dhe dashnorë shembullorë i librit, një autodidakt shumë planesh, i aftë të debatonte në çdo fushë dhe me njerëzit te rangjeve më të larta në fushën mendimit politik, etik dhe filozofik.

Ndue Mici ishte një kokë kaçurrele e mbushur plot poezi të Homerit, Dantes Pushkinit, Fishtës, Fanolit, Agollit e të tjerë. Hija e Veprave Tolstoit, Balzakut. Servatesit, Xhek Londonit, Petrarkës e Kadaresë u banë unak i vatrës së tij bibliotekare.

Sot Rrasa e Palajve që përkundi lëshoj një ofshamë të përlotur pasi humbi një nga djemtë më të hijshëm, që përkundi në djepin e saj madhështore.

Sot “Liburna” shqiptare humbi një nga pionieret e saj më të spikatur të marinës sonë tregtare. Shtatlartë, sportive, fytyrë purpurte, kaçurrel, me uniformën e bardhe të marinarit i ra kryq tërthorë deteve dhe oqeanëve nga Durrësi në Detin e Kinës Lindore, nga Gjibraltari në Karaibe, nga Argjentina në Afrikën e Jugut, nga Amsterdami në Kepin e Shpresës së mirë.

Në kohën kur ne nuk mund të shkonim lirshëm as deri në Vermosh, Ndue Mici, shëtitit të gjitha portet dhe kryeqytet me të rëndësishme te gjashtë kontinenteve te banueshme të globit.

I rrethuar prej joshjeve mondane, muzave ekzotik, uiskit, kaparit, shampanjës dhe kokakolës, një qind herë mund të behej dezertor dhe nuk e beri as nuk i shkoi në mëndje. I singertë, fisnik dhe burrërorë siç ia kishte tabani ku lindi e vijoj jetën, të cilën e shijoj me të gjitha ngjyrat e saj. Kur ishte në zenit të karrierës të shkëlqimit, rrezatuare të moshës e pësoi nga xhelozia dhe pabesia e kolegeve të vet më të afërt që shtynë drejt greminës vetëm për një ore super Atlantik apo dy tre gjela floriri të porositur nga miqtë e tij me pushtet, që braktisën për hiç gjë.

Ndue Mici njeri i qeshur, zemër bardhë, me qetësi shembulllore, kurrë nuk u qa e as nuk i ra gjoksit si heretik i vuajtur. Qeshte dhe thoshte gabova që besova! Në se mund të quhej faj çdo marinare gabonte kaq edhe me tepër, por mua më

shitoi xhelozia.

Sot, shoqata Atdhetare “Dukagjini” humbi një nga themeluesit, veprimtarin, mikun dhe bashkëpunëtorin shumë dashamirë në të gjitha veprimtaritë me të rëndësishme gjatë këtyre 22 viteve.

Ndue Mici i heshtur e pa fjale bashkëpunoi me shkrime e kontribute financiare për gazetën “Dukagjini”, të cilën e donte si biblën.

Ndue Mici që një njeri shartuar plot tharme burrërore malësie, me kulturën e qyteti dhe mbi të gjitha i ndriçuar nga drita e leximit. Këto tipare i ruajti gjithë jetës dhe as një herë nuk u shpërta as nga arkaizmi i vjetër e as nga jeta larushane e re. Sjellja e tij që fisnike dhe shembulllore nga do që i shkeli këmba, fisnikëria, njerëzia dhe dashuria e tij për Palajt, Shoshin, Dukagjinin dhe gjithë Shqipërinë ishin motoja e jetës së tij.

Ndue Mici çmoj, shijoi dhe dashuroi gjitha stinët e jetës. Ndue Mici e përgatit rrasën e varrit të vet. Nuk kërkoi epitete as lavdi. E shkroi me mundim e heshtje emrin Njeri i Mire.

Lamtumirë njeriu Ynë i mirë Ndue Mici!

Drita e amshuar të ngrohtë dhe të ndriçoftë shpirtin tënd te bardhe!

Kujtimi që le pas është kujtimi i njeriut të mirë dhe birit fisnik të Shoshit!

Faleminderit!

Prele Milani, Anton Kosteri,
Shkodër, 26 nëntor 2024

BIE NJË LIS NË NEW YORK, OSHTIMA NDIHET NË JEZERCE, ATJE KU LISI KA RRAJET

Një muej pas datëlindjes së 95 -të, mori rrugën e amshimit Prelë Kolë Balbona, i fundit prej 5 djemve të Kole Ndokes, truellit të Nikë Shytanit, prej Gjellave të Thethit. Këtu mblyllet kjo gjenerate e arte e 5 djemve të Kole Nokes dhe Lule Dedes (e bija e Dedë Koles prej Molles së Shoshit), që ishin si 5 lisa të rritun dhe ushqyem në ashten e burrnisë kreshnike të Shalës, e vaditun me limfen dardane - ilire, në truëllin e lashtë arbnor dukagjinas.

Historia e kësaj familje kap caqet e skajshme të krenarisë malsore, me sekuenca të dhimshme e tragjike, me sfida që vetëm një rracë elite e stërvitun në skllotën e rrebesheve të maleve tona, mund ti perballojnë e të dalin kryenalte.

Gjokë Kola prijësi, gojë ambel dhe i urtë, me kapuç të bardhë si bora e Jezer-



cës.

Prel Kola, puntori dhe motori i palodhun i shpisë.

Shuk Kola, politikani dhe diplomati, që nuk e mposhtën turturat e as burgu.

Pashko Kola, hero i pashpallur, që dha jetën në krye të detyrës, duke ju ardhë në ndihme shokëve.

Zef Kola, guximtari jetëshkurte, që dha jetë, me armë në dorë, në kërkim të lirisë.

Pesë vllazen, pesë histori të ndryshme, por e gjitha simbioze unike e familjes shaljane e dukagjinase.

Gjoka, Prela, Shuku me 11 pjestare të familjes, me 16 tétor të vitit 1978, moren aventurën “Liri apo Vdekje”, sfiduen sistemin komunist dhe çuen “dolline” në piramidën kufitare, në Qafë të Pejës, duke i thanë “Lumtumirë Shqipërisë së

rrethueme me tela, por me brengen dhe mallin në zemër e shpirt, për tokën dhe votren, që i lindi dhe rriti!”

Mbasi qendruen pak vite në Guci, u vendosen në New York me familjet e tyre si pjesë aktive dhe e nderueme e bashkësisë Shqiptaro-Amerikane.

Edhe pse lanë mrapa famiäljare të denjë, shumë përmallshëm i japim “Lamtumirën kësaj gjenerate të artë dinjiteti dhe krenarie, të djemve të Kolë Ndokës!”

Emni e ndera e shpisë tuj shndrritë gjithmonë si shndrritë Dielli në bjeshlet e Balbones!

Paçi paqen e perjetshme dhe kujtesën në brezat që vine!

Dedë Prendaj, New York



TRAJTËSAT KOHORE DHE PESHA EMOCIONALE NË PROZEN E GJON MARKUT, OSE PSIKOLOGJIA E TRADITËS NË ARTIN LETRARË

VËSHTRIM LIBRI GJON MARKU: “VIJ E HYJ BRENDA TEJE”, TREGIME, 2023



Tahir Bezhani

“Jam një germë e shkruar në gur prej stërgjyshërve të mi fisnik, ku fjala ruhet e shenjtë dhe e sh-trenjët” (autori)

Gjon Marku, një krijues i njohur anekënd trojeve tona shqiptare, i cili me veprat e tij letrare e shkencore, po le gjurmë te thella në rrugëtimin e tij, krijues me cilësi të larta prozaikë, poetike, duke udhëtuar kah majat e elitës krijuese. Pra, është një krijues brilant, i cili me talentin e shkathtësitë e veçanta, para publikut lexues kudo që folët shqipja, përherë e më tepër, po e zgjon kureshtjen tek masa e lexuesve të pasionuar. Tematikat e përzgjedhura në trajtimin e pendës së Gjon Markut, në prozën e shkurtër e të gjatë (së fundmi edhe në poezi), janë tema bashkëkohore të kohës, ku njeriu, qytetari jonë, gjendet i mbështjellë në lëvizhjen e kësaj problematike trajtuese. Gama gjithëpërfshirëse tematike jetësore nga penda e mprehtë e Gjon Markut, e ngritë autorin në pedestalin e krijuesit, aty ku dëshirojmë të gjithë ta kemi e ta lexojmë gjithmonë.

Gjitha ato që u ceken më lartë, lexuesi mund t'i shijojë në librin me tregime, “Vij e hyj brenda teje”, një libër solit me 270 faqe, ku gjejnë vend njëzet e katër tregime artistike me tematika të ndryshme nga ambiente të jetës sonë të përditshme, duke mos lënë anash assesit, traditat mirditase dhe jetën nën rrethanat e kohës së kaluar, si eminentë psikologjike e logjike e ngulitur në kujtesën tonë.

Librin me tregime “Vij e hyj brenda teje”, autori, si çdo krijues tjetër emblemantik, e fillon me vendlindjen, me ambientin jetësor të Mirditës së lavdishme, duke evokuar kujtimet e jetës, të cilat ia ngrisin përherë zjarrin e mallit e dashurinë për urëzat e oxhakut të kullave, aty ku fjala zë vend si guri.

Në tregimin e parë me titull “Të lutem më fal”, autori sikur se i kërkon falje truallit të vet, ambientit mirditas, nga i cili kohë më parë ka ikur në qendër të Tiranës për jetë e punë. Vizitat e herëpashershme vendlindjes, autorin e mbushin tej mase me nostalgji e mall, posaçërisht kur takohet me ata pleq të urtë e gojtar të Mirditës, me të cilët dikur, ka ndarë gëzimet e hidhërimet e jetës. Rasti i takimit gjatë një vizite me plakun Lalë Kola, ishte mjaft indikativ për të “ndeze” emocionet e përmallimit e autori, të cilin e takon “në cep rrugës ulur, shuaj e ndiz një llullë shqope, me një kollë ftohje në gjoks, ulur në një guri, të cilit i dridheshin thinjat nga flladi i maleve....”.

Në këtë rast, autori përshkruan momentin dhe e ndjen dhimbjen në thellësi, për faktin se nga fshati kanë ikur, (thua), e gjithë rinia jashtë vendit dhe zbrazësia shpirtërore ishte dukuri prekëse në të gjitha rrethanat... Kjo dukuri jo vetëm se është një hall jete të jetuarit në vetmi, por si dukuri (e pa përvojë), jashtë traditës. Nga ky këndvështrim, autori shpërthen me dufin e tij poetik, duke përshkruar momente të ndjeshme: “Brenda meje fle një dhimbje që nuk mbaron kurrë, sikur merr jetë e bëhet hija jote...”

Duke u thelluar në brendinë e këtij libri me shumë vlerë, në secilin tregim të lexuar, gjënë përditshmërinë e kohës në shumë aspekte, trajtuar me elokuencë artistike, nga një pendë tani e mirënjohur e prozës shqipe.

Gjon Marku, në tregimet e përfshira në këtë libër, nuk anashkalon aspektin e diskriminimit të institucioneve shtetërore nga të gjitha nivelet, si një dukuri tejet negative të kohës dhe të zhvillimit të demokracisë në vend. Korrupsionin, nepotizmin, imoralitetin, falsifikimet e ndryshme në çdo segment të jetës, janë dukuri me peshë mbi shoqërinë në ecje, të cilat pengojnë zhvillimin normal të individit dhe shoqërisë në tërësi. Njeriu i futur në shpirtin dhe zemrën e popullit, në këtë rast krijuesi letrarë si Gjon Marku, nuk e ulë kokën para dukurive të tilla, të cilat paraqesin shëmtinë pushtetarë dhe vrasin ndërëgjegjen qytetare, por i ve në spikamë, lufton dukuritë negative përmes pendës së tij.

Të gjitha prapësitë pushtetarë, autori më së miri i ka cekë në tregimin “Ti vjedh paratë e baxhanakut për me ble një diplomë”. Vet titulli i tregimit mjafton që të kuptojmë dukurinë që trajtohet brenda rreshtave të tij, e që ka peshë të veçantë shoqërore e politike, si dukuri...

Padyshim se Gjon Marku, në tregimet e tij artistike, trajton me një ndjenjë të veçantë aspektet e luftës në Kosovë, aty ku gjaku i derdhur këputi me gërshtë për një kohë dashurinë mes dy të rinjve nga tmerret e papara shkaktuar nga bishat e Karpateve. Njëherit, duke përshkruar sakrificat e papara e qëndresën heroike në trojet tona, autori tregon ndjenjën e kombëtarizimit. Sa bukur e me shumë emocione e përshkruan këtë situatë, qëndresë, përmes protagonistëve të tregimit, ku Valoni e Nora, zbërthejnë bukur esencën shpirtërore të qëndresës njerëzore. Nora i bashkëngjitet formacionit ushtarak të UÇK-së, duke luftuar me mish e me

shpirt për lirinë e vendit ndaj një barbari klasore.

Në këtë vazhde të rrëfimit, padyshim se, zgjojnë kureshtjen mëritë mes popujve me ngatërresa edhe kur takohen në qytete-shtete të ndryshme të Evropës si rasti i Danielit me Valonin në një universitet Zviceran. Valoni nuk dëshiron të vendoset në një dhomë konvikti me Danielin kinse ai e “pi duhanin”... Ky moment ceket si një rast eklatant mes “botës” së ngatërruar njerëzore, ku si mesazh shprehet dukuria civilizuese e pajtimin ndërnjerëzorë

Traditat dhe aspektet mitologjike në tregimet e Gjon Markut

Aspektet e traditës zënë një vend të veçantë në prozën e Gjon Markut, i cili me dije e nivel të lartë, i trajton si dukuri e fenomen i shoqërisë sonë shqiptare në të kaluarën dhe të tashmen. Fenomeni i vrasjeve (gjakmarrjes), si një plagë e vjetër, të cilën na e lanë në prehër armiqtë



tonë historikë, ndërsa ne e përkundim ende, si dukuri negative, në meset tona, për fatin e keq. Në tregimin “Monedha e munguar e gjakut”, përmes protagonistëve Pjetër Gjini e Deda, përmes të cilëve gërshetohet ngjarja e hidhur, vrasje, përshkruhen momentet tejet prekës, që nga akti i shëmtisë deri te akti fisnik i pajtimin mes tyre. Kulla, si gjithmonë, vendi i kuvendit te burrërisë e fisnikërisë, bujarisë shqiptare, trajtohet si pjesë historike iliro-shqiptare, me të gjitha veçoritë e trojeve tona shqiptare, kudo.

Në fillet e gjakimit të dy familjeve, kërkohet “BESA, sipas traditës kanunore, ndërsa djali i gjakësit tenton të dal nga kulla pa e pyetur babën, me ç’rast ba-

bai i thotë: “Pse ke dalë prej kulle babë, gjakësi kërkon të marrë hak e nuk na ka dhënë besë?...” Në këtë këndvështrim autori me vigjilencë ka dashur të venë në dukje mospajtimet mes gjeneratash, si e paarsyeshme vëllavrasja, dhe, si traditë, t’ia shpjegoj djalit “rregullat” rojës, ashtu si janë. Në këtë aspekt, mendoj se autori i librit, tregon gjithë dijen, talentin dhe filozofinë e jetës në rrethana të caktuara kohore. Tregimi “Monedha e munguar e gjakut” përfundon me pajtimin mes dy familjeve Pjetri - Deda, me angazhimin e njerëzve përparimtarë të rrethit, ilaka e gojtarë te vendit.

Ka një fenomen, që para ndodhive të këqija në familjet shqiptare, paraprijnë disa gjëra mitologjike, si lajmëtarë të keqes familjare. Këto paralajmërime mitologjike, vijnë nga krrokamat e korbit, shpendkeqes e disa zërave mistike të paparë, si ëndrrat e të tjera fenomene, ku autori i materializon mirë në prozën e tij dhe u jep konotacion filozofikë e historik.

Autori i librit “Vij e hyj brenda”, Gjon Marku, gjithë përfshirjen tematike në këtë libër, e libra të tjerë, e ka bërë, e bënë me një dashuri e përgjegjësi personale, ashtu siç duhet, me guxim e talent të përsosur. Përgjegjësia dhe dashuria, si dhe guximi ndaj veprimit që ndërmerr, gjithmonë të ngrisin në pedestalin e merituar.

Stili dhe gjuha si mjete artistike në prozën e Gjon Markut

Lexuesit e Gjon Markut, tani më, janë të njohur me karakteristikat e të shkruarit si në prozë, ashtu edhe në poezi. Gjuha e rrjedhshme, fjalët e përdorura në vendin e duhur sipas rrëfimit të rastit, “pa filozofime” siç ndodhë tek disa, përbëjnë një rëndësi nga vlerat e artit gjuhësorë të autorit. Në çdo rrëfim tregimtarë, bënë një përshkrim poetik të ambientit, të natyrës, fenomeneve natyrore sa që tregimi të gjason në prozën poetike. Ndonëse, këtë formë të shkruarit të tregimeve e konsideroj si stil personal dhe mjaft frymëzues e të qëlluar nga aspekti personal. Ka një dukuri që e dallon Gjon Markun në prozën e tij bashkëkohore. Ai është përdorues i shkathet i fjalëformimeve të reja, neologjizmave, që na bie në sy edhe si lëvruar i gjuhës shqipe.

Për librin me tregime, “Vij e hyj brenda teje”, mund të shkruhen edhe shumë e shumë faqe të tjera, komente e recensione nga këndvështrime të ndryshme, sepse, me të drejtë, secili lexues i librave të Gjon Markut, mund të nxjerrë konkludime të reja nga se i tëri është pasuri nisur nga shumë aspekte letrare.

TAHIR BEZHANI

Gjakovë, më 29 tetor 2024

*** Poezi nga Bukurie Buçpapaj *** Poezi nga Nikolin Lëmezhi ***



ISHTE, MBETET PO AJO

Ajo humbi puthjen diku
nëpër hënë,
E kishte parandier, madje
pat thënë: se fjala vret malet
malet me gjithë kreshtat.
Toruan ia fali muzgut
vjeshtarak
Heshti edhe pse do donte hak,
U pajtua çuditërisht me perëndimin.
Përqafoj muzgun me të artin diellin.
Nuancash ngjyronte në lirika vargje
Vajza hënë me vrimka në faqe,
E vranë, e shanë gjarpërinjtë,
Helmin riktheu mjalte
tek poezitë.
Mirësia vret të gjitha ligësitë,
ishte e mbetet po ajo hënë,
Që kurrë nuk e humbë bukurinë.

KJO NATË ...

Kjo natë po qanë në prehër yjesh,
i mungon përqaftimi i prituri i ditës,
Hëna e përkëdhel me tis buzëqeshjesh,
Sytë e natës, qajnë, rrëke pritjesh.

Retë këndojnë ninulla pandal ,
Bubullimore, zhurmëtare,
flakë, dhëmbje me natën ,
sikur dhe ato kanë,
Metonte të nesërmën si ditën më me fat.

E priste në thika të s'mprehura mirë,
Të agonte si gjithmonë i paduruar,
kishte përgatitur teren lufte të shtrirë,
Ndërsa ajo lindi ashtu me diellin përqaftuar.

NUK JE SI UNË

Ti nuk hesht, si heshtja ime,
as nuk dashuron në meditim,
kam të drejtën më sublime,
Të jem, e veterne në dashurim.

E VETMJA AROMË

(kushtuar vajzës time në ditën e vajzave sot)
Në gji e mbaj të vetmen aromë
lule trëndafil a menekshe,
Syri tim flen si një shqiponjë
Prej asaj dite që kur ti, ke le.
Ilaç për zemër, shërim shpirti
Vajzat janë bota e dashurisë,
Aty flen jeta e ti je motivi,
Streha ku prehem ndaj mërziisë.
Në një jetë me kaq sfida e derte,
banon e pambrojtur ti moj dritë,
Bëhesh nënë dallgë ke mbi vete,
Po ke një prehër ku fle pa frikë.

Qënka dita e vajzave sot,
vargjet rrodhën bashkë me lotë,
Mbaje shamin e vargut tim,
kur unë të mos jem, mbaje kujtim.

RILINDJE ME DIELLIN

Dhe ti buzëqesh me diellin
në rilindje romance po ashtu
Mbrëmë hënës itreguan sekretin,
ka pulsime vjeshtore mbi qiej blu.

E u panë në sy yjet lakmitarë,
retë e grinjtë larguan stuhinë,
është hëna,dielli, nata ,dëshmitarë,
Që përjetësojnë dashuritë.

MUAJ TË MBARË MIQ KJO NATË

Sonte kjo natë, kjo muzika,
drita e hënës në përqaftim yjesh,
gërmat që gdhendin lirika,
Fjalëza dritëhije emocionesh.

Qielli shtrat dashurie momentesh,
Në petalëza trëndafilash,
Ka shtruar rrugë epshjesh,
E ti ecën nazëmadhe me zë bilbilash.

Dashurisht, skenën romancë, krijuar,
për hënëzën aq të kërkuar, të dashuruar,
Nga gjithë yjësitë, univers epik,
Aty ku pushtetshëm flenë magjitë.

E ti je ajo, të marrësh frymë ke frikë,
Sidoqoftë ti adhuron të ëmblta poezitë,
Aty je vetëm ti ku dashuron pushtetshëm,
larg sa larg nga kupolat e ligësisë,

Lindjeagimesh fole e shtruar mirësisë.
U mpleksa me këtë qiell të tiranës,
Erajasemini me puthje të hënës.

AFËR E LARG

Ti je aq afër po ashtu je larg,
sa ç'është toka me universin
gjurmët i fshiu fjalaplagë,
Megjithatë mallin e bartë qyteti.

yjet zbresin në germa shpirti,
Vërdallë lazdrohen para hënës,
E bukur lëre, tashmë shkoi, iku.

Mbështeta zemrën mbi vargje,
Dhëmbjen treta ligësisë plakë,
Tek ty o zot gjeta qetësi, paqe,
vetëm ti m'i shero këto plagë.

Ky qytet, kjo natë , kjo botë,
Baladën kompozuan në ca pak lot,
U bëra poemë ,varg refreni
Nuk është aspak çudi aty më gjeni.

S'TË VRANË TY...

(Elegji kushtuar Martin Canit, vranë pafajësisht, në ambientet e shkollës, më 18 Nëntor 2024)

S'të vranë ty Martin,
vranë Shqipërinë!
S'të hoqën ty,
hoqën lirinë!

S'të varrosën ty Martin,
varrosën drejtësinë!
Kur mizorisht
të shuan fëmijërinë.

Ç'të qajmë ty Martin?
Qajmë pafajësinë.
Dhe lutemi që njerëzit
të njohin Dashurinë.

Familja e ky popull,
për ty s'do të marrin hak.
Se jeta jote e bukur,
s'paguhet me gjak.

Megjithëse kjo humbje
të gjithëve na pikëllon,
besimi yt i pastër,
për falje na mëson.

Martin, vëlla i vogël,
vdekja jote s'shkon kot,
përderisa besojmë
tek i madhi Zot.

Sa të bie dielli
akoma mbi këtë dhë,
Martin, o bir i dashur,
i shenjtë ti je për ne!

S'të vrau Mario, o Martin,
por e gjithë Shqipëria,
se është një popull,
që po vdes nga padija!

Prehu i qetë vogëlush,
se shumë e deshe jetën.
Kush të ka vranë ty,
ka vranë të vërtetën.

Lart nga qielli i kaltër,
ku tashmë s'ka asnjë re.
Martin, o biri ynë,
lutu ti për ne!

Nikolin Sh. Lëmezhi

Kallmet (Lezhë), më 24. 11. 2024

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziqi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin
GJERGJ KODRA

